

RAPORT

HARTIMI I HARTËS POTENCIALE USHTRIMORE TË INDUSTRIJË NXJERRËSE

Dhjetor, 2015

TABELA E PËRMBAJTJES

FJALOR.....	3
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT	6
3. OBJEKTI I PUNËS.....	8
4. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I METODOLOGJISË.....	9
4.1 INDUSTRIA NXJERRËSE.....	9
5. TREGUESIT GJENERIK TË REZULTUAR NGA RAPORTET E KOMPANIVE QË OPEROJNË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE	11
5.1 TREGUESIT EKONOMIKË DHE FINANCIARË	12
5.2 BASHKIA E BULQIZËS	33
5.3 BASHKIA E PATOSIT	51
5.4 BASHKIA FUSHË-ARRËZ.....	58
5.5 BASHKIA HAS	60
5.6 BASHKIA PËRRENJAS.....	63
5.7 BASHKIA PUKË.....	65
5.8 BASHKIA SELENICË	69
5.9 BASHKIA SKRAPAR.....	72
5.10 BASHKIA VAU I DEJËS	76
5.11 PASQYRIM I KUADRIT LIGJOR	80
6. INDIKATORËT SPECIFIK TË IMPAKTIT SOCIAL-EKONOMIK NË NJË RAJON TË ÇAKTUAR	86
7. VIZUALIZIMI DHE FUNKSIONALITETI I FAQES WEB.....	87
7.1 PROTOTIPI (WEB-MODEL).....	89
8. KONKLUZIONE	90
SHTOJCA 1. REFERENCAT	91
SHTOJCA 2 - PYETËSOR PËR BASHKITË	92
SH2.1 INDIKATORËT SPECIFIKË.....	94
SHTOJCA 3 – FAQE MODEL.....	97
3.1 FAQJA-MODEL E BASHKISË	97
3.2 FAQJA MODEL – KOMPANIA	101
SHTOJCA 4 – FORMA E RAPORTIMIT TË KOMPANIVE	102
SHTOJCA 5 – PËRMBLEDHJE E BURIMEVE TË TABELAVE.....	103

Shkurtimi	Shpjegimi
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
EITI Albania	Sekretariati EITI Shqiptar
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
MF	Ministria e Financave
MSG	Grupi i Punës Ndërinstitucional
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
OSHEE	Operatori Shpërndarjes Energjisë Elektrike
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Një nga sektorët më me rëndësi strategjike për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë ka qënë dhe mbetet sektori i nxjerrjes dhe përpunimit të naftës, gazit dhe mineraleve ku spikasin kromi, bakri, hekuri, nikeli, etj, si pasuri natyrore që kërkojnë gjithnjë e më shumë në tregjet globale. Zhvillimi industrial dhe i teknologjisë me ritme të larta, urbanizimi i vazhdueshëm i shumë vendeve dhe rajoneve, rritja e kërkesës për energji dhe produkte industriale, si dhe ndryshimet social demografike në shumë vende industriale dhe në zhvillim kanë bërë të mundur rritjen e kërkesës për produktet e këtij sektori, si dhe nevojën për një transparencë më të madhe për aktivitetet dhe veprimet që ndodhin në këtë industri.

Objektivi kryesor i këtij raporti është grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave të nevojshme për të ndërtuar dhe funksionuar një linjë informacioni publik online për të njohur, përdorur, analizuar dhe vlerësuar të dhënat e treguesve ekonomik – sociale dhe ligjore të zonave të industrisë nxjerrëse si dhe objektivat e arritura me qëllim për të iniciuar masa e veprime konkrete në ecurinë e mëtejshme në zonat e industrisë nxjerrëse.

Ky raport bazohet në një metodologji e cila së pari ka identifikuar burimet kryesore të informacionit nga institucionet kryesore që janë të angazhuar në procesin e mbikëqyrjes dhe administrimit të këtij sektori dhe së dyti ka seleksionuar ato produkte informacioni që kanë një rol të rëndësishëm për publikun, qeverinë, komunitetin e investitorëve dhe komunitetet lokale të rajoneve ku operojnë kompanitë e lincensuara për nxjerrjen dhe përpunimin e naftës, gazit dhe mineraleve.

Në vazhdimësi, projekti kërkon të përpunojë dhe të bëjë transparencën e treguesve të ndryshëm me karakter ekonomik, financiar, teknik, social, demografik dhe ligjor që përmes një metodologjie të kombinuar përfshin informacionin e të dhënave bazuar nga institucionet qendrore të cilat lidhen direkt me grumbullimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informacioneve që lidhen me industrinë minerare dhe të hidrokarbureve. Në raport është mundësuar gjithashtu një paraqitje e sintetizuar dhe elementë grafik në lidhje me këto të dhëna të grumbulluara.

Në strukturën e këtyre treguesve janë dalluar tregues statik të dhënë për një periudhë kohe të caktuar, për shembull viti 2014 si dhe të dhëna dinamike në seri kohore për periudha që shkojnë në disa vite. Gjithashtu, janë veçuar tregues gjenerik të sektorit, të cilat përfaqësojnë performancën e sektorit në shkallë vendi dhe tregues specifik që tregojnë situatën lokale të rajoneve të caktuara ku është investuar në këtë sektor.

Kombinimi i këtyre treguesve bën të mundur analizën e variacionit midis treguesve e variablave të ndryshëm të informacionit dhe arritjen e krahasueshmërisë si brenda sektorit ashtu dhe ndërmjet sektorit dhe sektorëve të tjerë, apo sektorit në vende të ndryshme dhe jep një panoramë të përgjithshme të këtij sektori që përmbush qëllimet e programit të transparencës për këtë sektor. Një nga gjetjet e këtij projekti është fakti i mungesës së një formati të plotë të informacionit në mënyrë hierarkike, i cili të ketë pjesët analitike të përshtatshme për tu sintetizuar në tregues sintetik në formë statike për një periudhë kohore dhe dinamike për një seri kohore.

Ky produkt informativ jepet nëpërmjet sistemit të tabelave dhe grafikut që kulmon në krijimin e hartës elektronike të informacionit të sektorit, e cila do të bëhet pjesë e faqes së Internetit të strukturës EITI Albania.

Për secilën nga bashkitë e marra në konsideratë është realizuar edhe një profil i përgjithshëm duke përfshirë të dhëna mbi gjeografinë, popullsinë, të dhëna me karakter ekonomik, financiar, teknik, social, për ato bashki ku këto informacione mund të mblidhen. Gjatë procesit u konstatua se shumica e bashkive nuk kishin të dhëna të publikuara dhe lehtësisht të kapshme dhe të përpunueshme.

Me qëllim krijimin e një produkti informativ, në formë raporti ose faqeje Interneti, ky raport rekomandon hapat e mëposhtme:

- Krijimi i një sistemi sistematik dhe periodik për grumbullimin e të dhënave nga bizneset e licencuara të industrisë.
- Identifikimi i të gjitha institucioneve që marrin dhe grumbullojnë të dhëna që lidhen me sektorin mineral, të hidrokarbureve si dhe të hidroenergjisë.
- Krijimi i një njësie përpunuese të të dhënave tek AlbEITI, e cila e menaxhon procesin vetë ose koordinon punën me agjencitë shtetërore, kompanitë dhe subjektet e licencuara dhe aktive.
- Standardizimi dhe përgatitja e tabelave gjenerike në format statik dhe dinamik, rezultat agregat i tabelave të krijuara nga institucionet grumbulluese. Përgatitja e hartave specifike.
- Përzgjedhja dhe grupimi i tabelave agregat sipas indikatorëve ekonomik, teknik, social-ekonomik dhe legjislativ.
- Hartimi dhe zbatimi i detyrave përkatëse për ndërtimin e një aplikimi në web i cili do të mundësojë fillimin e procesit të krijimit të një faqe internet/aplikim që të mundësojë vizualizimin e tabelave gjenerike dhe hartave respektive, si dhe lidhjen dhe integrimin e faqes dhe treguesve të evidentuar dhe analizuar me faqen e AlbEITI.
- Krijimi një protokoll pune për menaxhimin periodik dhe sistematik të faqes dhe promovimin e faqes në komunitet.
- Pasurim i vazhdueshëm me cilësi të reja, tregues dhe tabela të periudhave në vijim për informacionin në faqen e Internetit.

Rezultat i këtij projekti do jetë edhe faqja web, në të cilën do jetë e paraqitur harta e Shqipërisë me elementë interaktivë. Në hartë, bashkitë e marra në konsideratë do jenë të theksuara dhe mund të përzgjidhen nga përdoruesit. Përdoruesi do të ketë mundësinë që pasi të selektojë një nga bashkitë për të cilat është i interesuar të marrë informacion dhe pas zgjedhjes, ai do të drejtohet në një faqe tjetër në të cilën do të paraqiten të dhënat kryesore të analizuara për bashkinë e përzgjedhur.

Disa rekomandime

Procesi i identifikimit të të dhënave mbart shumë sfida, sidomos për të dhënat që lidhen me bashkitë, sic janë ato të ndikimit në komunitet, të efikasitetit të shfrytëzimit të burimeve minerare, hidrokarbure dhe hidroenergjitike, të transparencës së investimeve dhe kontributeve, të përfitimit të komunitetit nga të ardhurat e krijuara nga shfrytëzimi i burimeve të industrisë nxjerrëse në zonat përkatëse si dhe në nivel kombëtar, të rritjes së përgjegjësisë së bashkive dhe agjencive shtetërore të lidhura me industrinë nxjerrëse për ta grumbulluar dhe përpunuar këtë informacion etj. Mungon një burim periodik i këtyre të dhënave.

Procesi i grumbullimit të të dhënave dhe informacionit nga kompanitë duhet të realizohet nëpërmjet një sistemi të menaxhimit të informacionit, të rregullohet me aktet nënligjore dhe të programohet, evidentohet dhe ndiqet me afate kohore, si dhe të rritet shkalla e detyrimit të raportimit, detyrim që duhet të shtrihet ligjërisht te agjencitë shtetërore dhe subjektet private, por që kërkon edhe kombinim me strukturat e pushtetit vendor dhe INSTAT.

Grumbullimi i përgjegjshëm dhe sistematik i të dhënave të standardizuara, e shoqëruar me detyrim rregullativ dhe e mbështetur nga një sistem i menaxhimit të informacionit, mundëson rritjen e saktësisë së informacionit dhe transparencës, dhe përditësimin e saj periodik.

2. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Qeveria është plotësisht e vetëdijshme për rëndësinë e transparencës dhe qeverisjes së mirë përmes llogaridhënies dhe publicitetit të treguesve të këtyre sektorëve.

Qëllimet e detyrës nëpërmjet zbatimit të metodologjisë, është paraqitja e një informacioni të grumbulluar dhe përpunuar nga kontraktori, për zonat e industrisë nxjerrëse, në format të ngjashëm me atë të wikipedias, që kërkohet të zbatohet. Harta ushtrimore, ka qëllim të dyfishtë si më poshtë:

- Të njihet dhe të kuptohet ambienti i përgjithshëm i veprimeve dhe i të dhënave mbështetëse teknike-ekonomike-sociale-juridike në zonat e industrisë nxjerrëse në mënyrë për të nxjerrë në pah rezultatet e deritanishme dhe perspektivën e zhvillimit. Me rëndësi është dhe evidentimi i potencialeve ekzistuese të këtyre zonave apo fushat prioritare për të ndërhyrë si dhe boshllëqet që duhet të plotësohen në vijim për një zhvillim të qëndrueshëm.
- Për të përfituar nga bashkëpunimi midis strukturave shtetërore, shoqërive civile dhe grupeve të interesit duke identifikuar mundësitë për të mobilizuar veprime dhe marrje masash në të gjitha zonat e sektorët për të kapërcyer pengesat e dala dhe përsheptimin e suksesit të tyre.

Objektivi kryesor i këtij shërbimi është grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave të nevojshme për të ndërtuar dhe funksionuar një linjë informacioni publik online për të njohur, përdorur, analizuar, diskutuar e komentuar si dhe vlerësuar të dhënat e treguesve ekonomik – sociale dhe ligjore të zonave të industrisë nxjerrëse si dhe objektivat e arritura me qëllim për të iniciuar masa e veprime konkrete në ecurinë e mëtejshme në zonat e industrisë nxjerrëse.

Ne propozojmë metodologjinë dhe pamjen grafike të pasqyrimin të të dhënave për publikim në web.

Si pjesë e metodologjisë së ndjekur për mënyrën e paraqitjes dhe publikimit të të dhënave në web, është menduar paraqitja e të dhënave në një hartë, me një ndërfaqe grafike dinamike.

Në faqen web do të jetë paraqitur grafikisht harta e Shqipërisë në të cilën do të theksohen zonat e interesit, zona këto në të cilat janë bërë studimet dhe matjet e treguesve kryesore. Mënyra e funksionimit të hartës do të shpjegohet gjerësisht në seksionet e mëposhtme.

Duke lejuar përdoruesit për të marrë informacionin e nevojshëm përmes treguesve të ndryshëm si popullsia dhe dendësia e saj, niveli kualifikimit, niveli papunësisë, vendndodhja dhe shfrytëzimi i mineraleve, naftës e gazit, burimeve ujore etj., subjektet aktive të industrisë nxjerrëse dhe licencat e tyre, rezervat në industrinë nxjerrëse, të ardhurat e qeverisë dhe pushtetit vendor, projektet e financuara nga investitorët e donatorët vendas e të huaj, kontributin e industrisë nxjerrëse dhe asaj përpunuese në ekonominë e vendit dhe atë lokale etj., mund të kuptohen dhe përdoren më mirë marrëdhëniet ndërmjet / dhe me aktivitetet nxjerrëse, të dhënat social – ekonomike, legjislati etj., të cilat nga ana tjetër mund të lehtësojnë transparencën, llogaridhënien dhe të ndikojnë e ndihmojnë përmirësimin e nivelit të jetesës në zonat e industrisë nxjerrëse.

Procesi i dhënies së informacionit publik me fushë të gjerë do ndërtohet mbi bazën e:

Grumbullimit të treguesve të ndryshëm teknik, ekonomik, juridik dhe social.

Pasqyrimin të legjislati në fuqi për industrinë nxjerrëse.

- Pasqyrimin të treguesve në rang vendi dhe të detajuar sipas zonave të industrisë nxjerrëse.
- Pasqyrimin të problematikës së mbrojtjes së mjedisit dhe zgjidhjes së tyre.
- Komentimin të treguesve për ecurinë dhe problemet e evidentuara.

- Potencialit aktual dhe perspektiv të zonave të industrisë nxjerrëse si dhe të përdorimit të resurseve natyrore për një zhvillim të qëndrueshëm.
- Përmirësimit të nivelit të jetesës në zonat e industrisë.
- etj..

Si pjesë e objektivave është edhe sugjerimi i mënyrave të publikimit dhe përdorimi i tyre në faqen ekzistuese web: <http://www.albeiti.org>, pasi të ketë përfunduar procesi i grumbullimit, përpunimit dhe paraqitja e të dhënave në word, harta, grafike e forma të tjera statistikore apo informative.

Synimi do të jetë integrimi i informacioneve nga burime të ndryshme zyrtare shtetërore, shoqërive civile, grupeve të interesit si dhe komuniteteve apo individëve të ndryshëm të përfshirë në problematikën e gjerë të ecurisë dhe zhvillimit të industrisë nxjerrëse dhe përfitimit të komuniteteve në këto zona përmes transparencës dhe llogaridhënies së vazhdueshme.

Grumbullimi, analiza dhe komentet në këtë studim të të dhënave tekniko – ekonomike dhe social – juridike në zonat e industrisë nxjerrëse të vlerave aktuale dhe të perspektivës, do të bëhet:

- për zonat hidrokarbure (Bashkia Patos).
- për zonat minerare (Bashkia Bulqizë, Bashkia Fushë-Arrëz, Bashkia Pukë, Bashkia Has, Bashkia Skrapar, Bashkia Përrenjas dhe Bashkia Selenicë).
- për zonat hidroenergjetike (Bashkia Vau Dejës).

Me qëllim pasqyrimin e një informacioni sa më të plotë për njohjen e arritjeve deri tani dhe në vijueshmëri duke pasqyruar përdorimin e potencialeve të këtyre zonave. Treguesit dhe rezultatet e arritura do të pasqyrojnë ecurinë për një zhvillim të qëndrueshëm dhe me efekte pozitive në nivelin e jetës së zonave përkatëse si dhe në ekonominë shqiptare.

Qëllimi i detyrës është që të grumbullojë, prodhojë dhe paraqesë për publikim të dhëna të ndryshme teknike, ekonomike, juridike e sociale, të cilat do të informojnë publikun e gjerë, brenda dhe jashtë vendit, individë dhe subjekte të ndryshëm të interesuar në lidhje me trendin e treguesve dhe në përgjithësi për zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre zonave duke arritur objektivin për rritjen e fushëveprimit të raporteve Shqipëria EITI.

Raporti i Konsulentit do të paraqitet në Sekretariatit EITI Shqiptar dhe MSG duke u bërë publikisht i disponueshëm.

3. OBJEKTI I PUNËS

Të grumbullojë, të shqyrtojë, analizojë dhe komentojë tregues të ndryshëm (në rang vendi dhe zonal) si:

Tregues teknikë në vite (p.sh. si hartat, licencat, niveli i rezervave, shfrytëzimi i tyre, cilësia e realizuar, vendndodhja, lloji dhe cilësia e mineraleve, naftës e gazit, burimeve ujore, kontrolli i mineralit dhe naftës, investimet sipas kompanive gjithsej dhe në veçanti për prodhimin dhe për mjedisin, për kualifikimin, etj.).

Tregues ekonomik – financiarë në vite (p.sh. si makro- dhe mikroekonomike, buxheti, volumi, prodhimit dhe renta minerare grumbulluar dhe shpërndarë në zonat përkatëse, numri i kompanive në zonë, tatim fitimi, TVSH, gjobat ose penalitetet tatimore, dividendet dhe tatim fitim mbi të, numri i të siguruarve në punë, pagesat e bëra për pushtetin vendor dhe atë qendror nga të gjitha kompanitë regjistruar në zonat përkatëse, të cilat aktualisht veprojnë dhe krijojnë të ardhura për buxhetin e shtetit, investimet në tërësi dhe detajuara sipas degëve ekonomike, niveli i të ardhurave të zonës në tërësi dhe sipas degëve ekonomike në totalin e të ardhurave të shtetit dhe PBB ose GDP, niveli i punësimit në tërësi dhe sipas degëve ekonomike, eksporti dhe importi, niveli i çmimeve të shitjes së mineralit dhe atij të përpunuar, niveli i çmimeve në bursën ndërkombëtare etj.).

Tregues socialë në vite (p.sh. si numri i të punësuarve në industrinë nxjerrëse sipas zonave, niveli i papunësisë, niveli arsimor, investimet sipas sektorëve në zonat përkatëse, ndarja sipas gjinive, vdekshmëria në të mitur, të ardhurat për frymë, konsumi i familjeve, numri i institucioneve të kulturës, artit, sportit, importi i mbetjeve, treguesit e varfërisë në zonë/rajon, paga mesatare, të ardhurat e familjes, tregues e të dhëna apo probleme të ngritura nga shoqëria civile etj.).

Tregues gjeografikë dhe demografikë në vite (p.sh. si popullsia dhe dendësia e saj, grup-moshat e popullsisë, numri i të punësuarve, sa prej tyre gra, sa prej tyre grup-mosha e të rinjve, lindjet dhe shtesat natyrore, mbetjet e ngurta urbane dhe inerte, erozioni tokës, etj.).

Pasqyrim të kuadrit ligjor që rregullon sektorin e industrisë nxjerrëse, hidroenergjisë, procedurat, licencimin, regjistrimin, funksionimin dhe aktivitetin e industrisë nxjerrëse përfshirë dhe ato në aspektin financiar, bankar, tatimor, doganor etj.

Bërjen transparente të treguesve të ndryshëm si ato të rezervave minerare, emërimit të subjekteve aktive që veprojnë në zonë, treguesve social – ekonomike etj. përmes një metodologjie të kombinuar, e cila përfshin informacionin e të dhënave bazuar nga institucionet qendrore si:

- Instituti Statistikave – INSTAT;
- Ministria e Energjisë dhe Industrisë – MEI;
- Ministria e Financave – MF;
- Sekretariati EITI Shqiptar – EITI Albania;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore – AKBN;
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar – SHGJSH;
- Enti Rregullator Energjisë – ERE;
- Korporata Elektroenergjetike Shqiptare – KESH;
- Operatori Shpërndarjes Energjisë Elektrike – OSHEE;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve – DPT;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave – DPD;
- Pushteti Vendor (NJQV).

Objekti i përfundimtar është të grumbullohet informacioni i gjerë dhe të dhënat e kërkuara me tregues të ndryshëm, të kuptueshëm dhe të krahasueshëm kohë pas kohe duke i bërë të aplikueshme në Website ekzistues.

4. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I METODOLOGJISË

Të dhënat e integruara të sektorit të hidrokarbureve janë rezultat i analizës së burimeve kryesore të informacionit në Shqipëri si dhe praktikave më të mira globale të cilat reflektojnë standardet, principet dhe interesat e aktorëve kryesore dhe shoqërisë në përgjithësi për zhvillimin e sektorit të hidrokarbureve. Burimet kryesore si AKBN, INSTAT, SHGJSH, ERE, INSTAT etj. dhe studime specifike nga Agjencia e Autorizuar janë marrë në veçanti në konsideratë.

Treguesit janë ndërtuar mbi bazën e formatit të raportit të dhënë nga kompania që është dhe njësia bazë e informacionit dhe grupuar në nivel rajonal, në nivel produkti dhe industrie.

Treguesit gjenerikë jepen në formatin statik për një periudhë raportuese ose në nivel dinamik në një seri kohore ose nëpër vite.

Treguesit janë ndërtuar mbi bazën e formatit të raportit të dhënë nga kompania që është dhe njësia bazë e informacionit dhe grupuar në nivel rajonal, në nivel produkti dhe industrie.

4.1 INDUSTRIA NXJERRËSE

Shqipëria është një vend i pasur me naftë dhe burime minerare. Kërkim – zbulimi, shfrytëzimi dhe përpunimi i këtyre pasurive nëntokësore, përbën një komponent të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Për shumë kohë industria nxjerrëse ka qenë një faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit.

Sektori i industrisë nxjerrëse në Shqipëri përfaqësohet nga sektori industrial i naftës dhe sektori mineral, ky i fundit i përqendruar kryesisht në prodhimin e kromit, bakrit, hekur nikelit, bitumit e zhavorreve bituminoze dhe mineraleve që shërbejnë si lëndë e parë në industrinë e ndërtimit.

4.1.1 SEKTORI HIDROKARBUR, NAFTA E GAZI NATYROR

Shqipëria ka rezerva të konsiderueshme të naftës dhe gazit, si në tokë dhe në det të cilat kanë inkurajuar investitorët e huaj, për të filluar gjurmimin dhe kërkimin për zona të pazbuluara të naftës dhe gazit. Akumulimet hidrokarbure janë burime të papërsëritshme nëntokësore natyrore, nëpërmjet të cilave Shqipëria ka gjeneruar vazhdimisht fonde të rëndësishme financiare.

Veprimtaria hidrokarbure në Shqipëri i ka fillimet e saj rreth viteve 1800, kur u kryen ekspeditat e para gjeologjike, dhe më pas rreth viteve 1900, kur këto operacione u intensifikuan më tej dhe u kurorëzuan me zbulimin e mjaft vendburimeve të naftës dhe gazit. Bashkëpunimi me industrinë ndërkombëtare të naftës ka filluar në fillim të viteve 1900, kur u dhanë një numër koncesionesh për shoqëri të huaja, nga më të mëdhatë e kohës. Pas viteve 1990 janë zhvilluar disa raunde licencimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve dhe janë lidhur një numër marrëveshjesh hidrokarbure me shoqëri të huaja. Kërkimi i naftës në Shqipëri filloi në vitin 1918. Që nga ajo kohë, u zbuluan fusha naftë-mbajtëse në 11 zona tokësore duke përfshirë: Drashovicë (1918), Patos (1927), Kuçovë (1928), Marinzë (1957), Visoka (1963), Gourisht-Koçul (1965), Ballsh-Hekal (1966), Finiq-Krane (1973), Çakrran-Mollaj (1977), Delvinë (1989) dhe Sqepur (2001).

Kërkimi i gazit në Shqipëri filloi në vitin 1955. Fusha e parë gaz-mbajtëse u zbulua në Divjakë (1963), e ndjekur nga Frakulla (1965), Ballaj-Kryevidhi (1983), Povelça (1987), Panaja (1988), dhe Ad-4 (në det – 1994).

4.1.2 SEKTORI MINERAR

Shqipëria është e njohur për rezervat e kromit, hekurit, nikelit dhe bakrit. Zbulimi, shfrytëzimi dhe përpunimi i tyre, përbën një aktivitet të rëndësishëm për ekonominë e vendit. Tradicionalisht, mbas vitit 1944, industria nxjerrëse dhe e përpunimit të mineraleve si kromi, bakri, hekuri, qymyrguri, ka siguruar të ardhura të konsiderueshme. Shqipëria numëron një numër kompanish të mesme dhe të vogla shfrytëzimi (nëntokësore), një numër në rritje të kompanive të shfrytëzimit karrierave sipërfaqësore (gurore) dhe vetëm dy-tri kompani të mëdha minerare-industriale. Sektori ka qenë tërësisht i dominuar nga ndërmarrjet shtetërore dhe në vitin 1994 me miratimin e ligjit të ri minerar filloi të hapet ndaj investimeve private.

Vendi ka një histori të gjatë në sektorin minerar me depozita të mëdha të mineraleve të kromit, nikelit, bakrit dhe gurit gëlqeror. Rezervat e kromit janë vlerësuar rreth 36.9 milionë ton dhe rezervat e bakrit rreth 27 milionë ton. Reformat në industrinë minerare paraqesin sfida të konsiderueshme të qeverisjes.

4.1.3 SEKTORI I HIDROENERGJISË

Hidroenergja është burimi më i madh i energjive të rinovueshme në vendin tonë. Shqipëria renditet në Europë si një vend me pasuri ujore të konsiderueshme, me një shtrirje hidrografike të shpërndarë pothuajse në të gjithë territorin. Shqipëria, me sipërfaqen e saj prej 28 748 km², ka një shpërndarje hidrografike me një sipërfaqe ujëmbledhëse prej rreth 44,000 km² ose 57% më shumë se territori shtetëror.

Sektori i Energjisë Elektrike dhe ai i Gazit Natyror në vendin tonë rregullohen në bazë të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe Ligjit Nr. 9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar.

Prodhimi hidro-energjitik në Shqipëri dominohet nga sektori publik. Në fund të vitit 2014, Shteti Shqiptar zotëronte dhe administronte Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare (KESH), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE).

Duke iu referuar raportit EITI 2013-2014 KESH është prodhuesi më i madh në vend. Me një kapacitet të instaluar prej 1,448 MW ose 80% të fuqisë totale të instaluar në vend, ndërtuar në kaskadën e lumit Drin në veri, KESH gjeneroi rreth 87% të prodhimit të energjisë në vitin 2013. Kjo peshë ra në 72% në vitin 2014, për shkak të rritjes së aktivitetit të HEC-eve private dhe HEC-ve me konçesion në këtë sektor.

Struktura e kostos së prodhimit të brendshëm të energjisë ka ndryshime në 5 vitet e fundit, me rritjen e prodhimit nga HEC-t private dhe me konçesion dhe pritjet të ndryshojë edhe më tej në të ardhmen, kur një numër i madh HEC-sh të mesme dhe të vogla me konçesion do të hyjnë në fazën e prodhimit.

Të dhënat e raportuara nga AKBN tregojnë se një numër i madh HEC-sh dhënë me konçesion nuk kanë filluar ende ndërtimin ose janë ende në ndërtim e sipër në datën e këtij raporti, duke shfaqur vonesa me dy ose më shumë vite. Më konkretisht, nga 502 HEC-e dhënë me konçesion, 308 HEC-e me fuqi të instaluar prej 1,152 MW dhe energji të parashikuar prej 5,359 GWh nuk kanë filluar ende ndërtimin. Ndërsa 84 HEC-e janë në fazën e ndërtimit. Nëse të gjitha HEC-et do të kishin përfunduar ndërtimin brenda dy vjetëve nga data e konçesionit dhe do të prodhonin energjinë e parashikuar në kontratën e konçesionit, tarifa e konçesionit do të ishte rreth 1.78 miliard lekë në vitin 2013 dhe rreth 1.9 miliard lekë në vitin 2014. Këto vlera janë mbi 10 herë më shumë se të ardhurat nga tarifa e konçesionit e mbledhur në të dy vitet.

5. TREGUESIT GJENERIK TË REZULTUAR NGA RAPORTET E KOMPANIVE QË OPEROJNË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE

Treguesit gjenerik janë tregues të përgjithshëm të sektorit që tregojnë ecurinë dhe performancën e këtij sektori. Këto tregues bazohen kryesisht në raportin që kompania është e detyruar të paraqesë në AKBN për aktivitetin e saj si dhe në të dhëna të grumbulluara nga institucionet e tjera mbikqyrëse si Ministria e Financave, Drejtoria e Doganave, apo institucione të administrimit të informacionit si INSTAT, etj..

Në hulumtimin e gjerë të gamës së informacionit që duhet të përpilohet kërkohet që raporti i informacionit nga kompanitë nxjerrëse dhe përpunuese të këtij sektori të plotësojnë më mirë një sërë kërkesash informative për tju përgjigjur më mirë interesit publik dhe atij të komunitetit të investitorëve. Treguesit nxjerrin një panoramë të përgjithshme të aktivitetit të këtij sektori, rolit të tij në ekonominë shqiptare, si dhe perspektiven për më shumë investime dhe rritjen e prodhimit në funksion të punësimit dhe zhvillimit ekonomik të rajoneve dhe vendit.

Treguesit gjenerik rekomandohen të plotësohen dhe të përmisohen në të ardhmen mbi bazën e formatit të raportimit të kompanive që janë lincensuar në nxjerrjen, përpunimin dhe shitjen e hidrokarbureve dhe mineraleve në Shqipëri.

Njësia bazë e informacionit është raporti i kompanisë i cili rekomandohet të plotësohet i plotë nga kompania dhe që përmban elementet e përcaktuar tek VKM nr. 233, datë 23-03-2011, apo dhe në dokumenta të tjera legjislativë. Praktika jonë dhe praktikat e mira ndërkombëtare tregojnë që forma e raportimit për kompanitë përfshijnë informacione që lidhen me elementët strategjikë dhe organizativë si më poshtë (shiko Shtojca 4 për detaje):

Strategjia e kompanisë

- Prioritetet strategjike dhe çështjet kryesore në afat të shkurtër dhe të gjatë me synim qëndrueshmëri e biznesit dhe në plotësim të standarteve ndërkombëtare të strategjisë organizative për arritjen e suksesit.
- Tendencat kryesore që ndikojnë tek kompania dhe tek prioritetet e saj.
- Arritjet kryesore dhe problemet në periudhën raportuese.
- Performanca në lidhje me objektivat.
- Prodhimi, shitjet, investimet, taksat, renta, punësimi.

Profili organizativ

- Emri dhe NIPT-i i kompanisë
- Produktet kryesore dhe shërbimet
- Vendndodhja e kompanisë dhe i operacioneve
- Statusi ligjor dhe çështje të pronësisë
- Tregjet kryesore lokale kombëtare apo ndërkombëtare
- Indikatorët
- Marrëveshja me qeverinë
- Plani i investimeve dhe risqet financiare
- Plani i mbrojtjes së ambientit

Treguesit e nxjerrë nga raporti i kompanisë grupohen në nivel produkti industrie qarku dhe kombëtar. Sidoqoftë bazuar në raportet ekzistues, përmbledhja e informacionit ka si qëllim paraqitjen sintetike dhe të

integruar të indikatorëve kryesorë të sektorit hidrokarbur, të mineraleve dhe të hidroenergjisë të grupuar në kategoritë e mëposhtme:

- Tregues ekonomiko-financiarë të sektorit sipas produkteve, rajoneve dhe industrisë
- Tregues social-ekonomikë të rajonit ku operon firma nxjerrëse apo përpunuese
- Tregues teknikë
- Tregues të legjislacionit rregullues

5.1 TREGUESIT EKONOMIKË DHE FINANCIARË

Në këto kategori janë përfshirë një sërë treguesish që karakterizojnë performancën e përgjithshme të kompanive që veprojnë në këtë sektor dhe që ofrojnë një vlerësim të shpejtë mbi qëndrueshmërinë dhe stadin e ciklit të rritjes dhe zhvillimit të këtyre kompanive nga pikëpamja ekonomike dhe financiare.

Këto janë treguesit gjenerik, të cilët janë ndërtuar mbi bazën e informacionit si më poshtë:

- Rezervat minerare
- Investimi
- Prodhimi
- Qarkullimi ose xhiro vjetore
- Eksporti vjetor
- Punësimi
- Kontributi në taksa dhe tatime
- Kontributi në rentën minerare
- Rentabiliteti
- Produktiviteti

Burimi kryesor i informacionit për këto tregues është materiali i përpunuar nga AKBN i deklarimit të subjekteve për 2014 dhe në dokumenta të ngjashme për vitet e tjera.

5.1.1 TREGUESIT GJENERIK TË SEKTORIT TË MINERALEVE PËR VITIN 2014 SIPAS LLOJIT TË PRODUKTIT

Minerali	Prodhimi ton ose m3	Investimi lek	Të ardhurat lek	Renta lek	Nr. Punonjësve
Krom	683.874	2.430.311.528	2.473.855.415	148.431.325	2.955
Bakër	259.138	65.196.025	2.721.194.630	120.658.280	235
Fe Ni-Ni Si	535.128	227.719.178	17.018.686	52.264.137	86
Gur gëlqeror	3.165.867	167.679.383	13.831.285.171	177.149.052	606
Total		2.890.906.114	19.043.353.902	498.502.794	3.882

Tabela 1 - Treguesit gjenerik të sektorit të mineraleve për vitin 2014 sipas llojit të produktit

Burimi: AKBN, RAPORTI VIETOR 2014, Volumi I

5.1.2 TË ARDHURAT E QEVERISË NGA SEKTORI I HIDROKARBURE DHE I MINERALEVE

	2013						2014					
<i>Rrjedha e pagesave (*)</i>	Albpetrol	AKBN	ERE	KESH	Buxheti Kombëtar	Totali	Albperol	AKBN	ERE	KESH	Buxheti Kombëtar	Totali
Ndarja e prodhimit të naftës	4.968	-	-	-	-	4.968	4.354	-	-	-	-	4.354
Bonuset	11	47	-	-	-	58	12	23	-	-	-	35
Tarifë konçensioni	-	-	-	133	-	133	-	-	-	190	-	190
Pagesat rregullatore	-	-	23	-	-	23	-	-	72	-	-	72
Të tjera	-	-	-	-	-	-	-	633	-	-	-	633
Renta minerare	-	-	-	-	10.037	10.037	-	-	-	-	9.730	9.730
Tatimi mbi fitimin(**)	-	-	-	-	2.885	2.885	-	-	-	-	2.224	2.224
Dividendë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	757	757
Të ardhura nga privatizimi	-	-	-	-	15.439	15.439	-	-	-	-	-	-
	4.979	47	23	133	28.361	33.543	4,366	656	72	190	12.711	17.995
Nafta dhe gazi	4.979	47	-	-	9.970	14.996	4,979	656	-	-	9.904	15.539
Minerale	-	-	-	-	2.433	2.433	-	-	-	-	2.554	2.554
Hidroenergja	-	-	23	133	15.959	16.115	-	-	72	190	253	515

Tabela 2- Të ardhurat e qeverisë nga sektori i hidrokarbure dhe i mineraleve

Burimi: Raporti EITI 2014

5.1.3 PRODHIMI, PUNËSIMI DHE RENDIMENTI I INDUSTRIË SË NAFTËS, GAZIT DHE MINERALEVE

Periudha	2011			2012		
Treguesit	Prodhimi mil lek	Punësimi	Rendimenti mil lek për punonjës	Prodhim mil lek	Punësim	Rendiment mil lek për punonjës
Naftë dhe gaz	47.900	4.700	10,2	50.300	3.700	13,5
Minerale	22.800	3.800	6	15.500	4.100	3,8
Totali	71.600	8.500	8,4	65.800	7.800	8,4
Periudha	2013			2014		
Treguesit	Prodhimi mil lek	Punësimi	Rendimenti mil lek për punonjës	Prodhim mil lek	Punësim	Rendiment mil lek për punonjës
Naftë dhe gaz	58.300	3.941	14,8	60.390	3.109	19,4
Minerale	15.510	3.800	4,1	19.305	4.100	4,7
Totali	73.810	7.741	9,5	79.695	7.209	11,1

Tabela 3- Prodhimi, punësimi dhe rendimenti i industrisë së naftës, gazit dhe mineraleve

Burimi: EITI – Raporti 2012 (për vitet 2011 dhe 2012), Raporti 2014 (për vitet 2013 dhe 2014) - albeiti.org- 1 USD = 110 Lek




Figura 1. Prodhimi i industrisë së gazit, naftës dhe mineraleve




Figura 2. Punësimi i industrisë së gazit, naftës dhe mineraleve




Figura 3. Rendimenti i industrisë së gazit, naftës dhe mineraleve




Tabela 4 / Figura 4. Treguesit e lejeve të shfrytëzimit të mineraleve për vitin 2014 sipas rajonit

Burimi: Raporti i AKBN, vëllimi i parë 2014, tabela 1

5.1.5 TREGUESI DINAMIK I PRODHIMIT TË DISA MINERALEVE NË VITE (NJËSIA 000 TON/NM3)

Lloji i mineralit	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Krom	202	225	284	328	350	360	521	684
Bakër	98	105	114	140	605	480	508	260
Hekur nikel dhe nikel silikat	370	353	69	269	364	75	215	535
Gur gëlqeror	1.716	3.838	3.272	2.363	2.446	2.727	1.811	3.166
Argjilë	765	649	796	795	973	961	768	810
Gips		87	71	77	93	91	112	107

Tabela 4- Treguesi dinamik i prodhimit të disa mineraleve në vite (Njësia 000 Ton/Nm3)

Burimi: Raporti EITI 2012 dhe Raporti EITI 2014

5.1.6 GRUMBULLIMI I RENTËS MINERARE NË VITE (NË MILIARDË LEKË)

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Renta minerare në eksport		0,77	2,12	3,65	5,85	0,995	0,817
Renta minerare mbi shitjet brenda vendit	0,63	0,69	2.00	1,26	1,30	0,74	1,093

Tabela 5 - Grumbullimi i Rentës minerare në vite (në Mil lekë)

Burimi: Raporti EITI për vitet 2012 dhe 2014




Figura 5. Renta minerare (eksport dhe shitje brenda vendit) për periudhën 2008-2014

5.1.7 EKSPORTI I NAFTËS DHE GAZIT, KROMIT DHE BAKRIT NË VITET 2011 DERI NË 2014

	2011	2012	2013	2014
Naftë dhe gaz	31,7	53,3	69,5	55
Krom	11,5	9,3	9,6	8,1
Bakër	4,2	5,5	4,7	2,5

Tabela 7 - Eksporti i naftës dhe gazit, kromit dhe bakrit (2011-2014) në Mld. Lekë

Burimi: Raporti EITI 2012 dhe 2014

5.1.8 TREGUESIT TEKNIK TË NAFTËS DHE GAZIT

Këto tregues pasqyrojnë karakteristikat natyrore të vendndodhjes së pasurive natyrore dhe cilësinë e mineralit që nxirret nga këto rezerva natyrore.

Vendndodhja	Viti i zbulimit	Lloji i rezervuarit	Dendësia e naftës dhe gazit	Përmbajtja e sqfurit
Drashovicë	1918	Oligoc-flysch	Naftë < 10 °	n/i
Patos	1927	Mess-clastics	Naftë (12-24° API)	2.5-6
Kucovë	1928	Mess-clastics	Naftë (13-16° API)	4
Marinza	1957	Mess-clastics	Naftë (12-35° API)	4-6
Visoka	1963	Cret/Eoc.Carb	Naftë (5-16° API)	5-6

Gotisht	1965	Cret/Eoc.Carb	Naftë (17° API)	6
Ballsh	1966	Cret/Eoc.Carb	Naftë (12-24° API)	5.7-8.4
Cakran	1977	Cret/Eoc.Carb	Naftë 14-37 ° AP)IKond, 52 ° API	0.9
Finiq	1973	Cret/Eoc.Carb	Naftë (<10° API)	3.7-4.3
Delvina	1989	Cret/Eoc.Carb	Naftë (31° API) Kond. 53 ° API	0.7
Divjaka	1963	Tort/clastics	Gaz & Kondens	n/i
Ballaj	1983	Piloc/clastics	Gaz	n/i
Frakull	1965	Mess-clastics	Gaz	n/i
Povelca	1987	Mess-clastics	Gaz & Kondens	n/i
Panaja	1988	Mess-clastics	Gaz	n/i
Adriatik	1994	Mess-clastics	Kond. 54.3° API	n/i
Sqepuri	2001	Cret/Eoc.Carb	Naftë (37° API)	2.3

Tabela 8 - Treguesit teknik të naftës dhe gazit
Burimi Raporti EITI 2012, tabela 5

5.1.9 TREGUESIT TEKNIK TË DISA MINERALEVE

(Burimi për të gjitha tabelat (9-12): "Zhvillimi i qendrushëm i veprimtarive minerare në Shqipëri"- Sokol MATI)

Tipi i mineralizimit	Sasia në ton	Përmbajtja e Bakrit në %	Sasia e shfrytëzuar në ton	Rezervat e mbetura në ton
Rezervat e mineralit të bakrit në mineralizimin kuarc sulfur	13.658.465	1154	4.925.501	5.923.037
Rezervat e mineralit të bakrit në mineralizimin sulfur i tipit vullkanogjen	50.101.069	1,38	7.558.572	29.076.187
Rezervat e mineralit të bakrit në mineralizimin vullkano-sedimentare	8.208.820	1,95	6.744.870	1.558.000
Rezervat e mineralit të bakrit në mineralizimin e zonave të tjera tektonik të Shqipërisë	1.031.244	1,56	0	1.031.244
Totali	72.999.598	1,48	19.228.943	37.588.468

Tabela 9 - Rezervat e mineralit të BAKRIT sipas shpërndarjes së tyre në tipet e mineralizimit

Vendburimi	Rezervat në ton	Hekur (%)	Nikel (%)
Bitinckë	50.200.000	16,38	1,28
Trull-Surroj-Manzë	48.900.000	20,00	0,98
Nome (Kukës)	3.200.000	21,75	1,22
Totali	102.300.000	18,28	1,13

Tabela 10 - Rezervat gjeologjike të Nikel-Silikat

Rajoni	Sasia në ton	Hekur (%)	Nikel (%)
Rajoni Krumë-Kukës-Lurë	30.500.000,00	38,66	0,8-1,1
Rajoni Bitincka	59.193.000,00	38,66	1,074
Rajoni Librazhd Pogradecit	215.800.000,00	38-44	0,5-1
Rajoni e tjera	2.100.000,00	20-24	0,2-0,3
Total Hekur-Nikel	307.593.000,00	20-24	0,2-1,1

Tabela 11 -Rezervat gjeologjike të Hekur- Nikelit

Vendburimi	Rezerva gjeologjike në milion ton
Treblövë	140
Kasnicë	45
Visokë	61
Totali	246

Tabela 12 - Rezervat gjeologjike të rërave bituminoze në Shqipëri

5.1.10 KONTRIBUTI INDUSTRISE NXJERRESE NË EKONOMINË SHQIPTARE (MILIARD LEKË)

	2011	2012	2013	2014
Prodhim i naftës dhe gazit	47,9	50,3	58,3	60,39
Prodhimi minerar	22,8	15,5	15,5	19,3
Prodhimi Total	70,7	65,8	73,7	79,7
Kontributi në PBB	4,3%	5,6%	3,7 %	3,4 %

Tabela 13- Kontributi industrisë nxjerrëse në ekonominë shqiptare (miliard lekë)

Burimi: Raport EITI 2012, 2013-2014 Kursi i këmbimit 1 USD = 110 Lek




Figura 6. Prodhim i industrisë nxjerrëse




Figura 7. Kontributi në PBB i Industrisë nxjerrëse për periudhën 2011-2014

Aktiviteti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Industria Nxjerrëse	11.223	10.117	14.992	22.318	27.390	33.681	40.683	48.174
Industria Përpunuese	84.006	93.829	113.512	117.498	112.628	114.405	120.650	126.650

Tabela 14- Prodhimi i Brendshëm Bruto ndër vite sipas aktivitetit

Burimi: Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Projekti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2015- 2017, <http://www.financa.gov.al/>

Aktiviteti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Industria Nxjerrëse	31,8	-10,0	34,3	42,3	21,0	19,5	17,5	14,3
Industria Përpunuese	6,2	13,4	16,9	-8,9	-4,9	-0,9	2,9	2,7

Tabela 15- Rritja reale vjetore e Prodhimit të Brendshëm Bruto sipas aktivitetit ekonomik (në %)

Burimi: Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Projekti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2015- 2017, <http://www.financa.gov.al/>

Aktiviteti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Industria Nxjerrëse	0,3	-0,1	0,3	0,5	0,4	0,4	0,4	0,4
Industria Përpunuese	0,5	1,0	1,4	-0,8	-0,4	-0,1	0,2	0,2

Tabela 16- Kontributi i Sektorëve të Industrisë në rritjen reale të PBB (në pikë %)

Burimi: Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Projekti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2015- 2017, <http://www.financa.gov.al/>

5.1.11 DEKLARIMET VJETORE KALENDARIKE TË SUBJEKTEVE NË SHQIPËRI PËR VITIN 2014

Nr	LLOJI I MINERALIT	PRODHIMI		Investimet						Te ardhurat		RENTA	
		ton	m3	P. Minerare		Mak. &Paisje		Shuma		USD	Leke	USD	Leke
				USD	Leke	USD	Leke	USD	Leke				
1	ARGJILE	810.093,6			2.619.460		200.000		4.719.460		7.066.205.414		82.400.801,48
2	BAKER	259.137,56		1.754.229,00	56.035.217	710000	9.160.808	2.464.229	65.196.025	24.738.133			120.658.280
3	BAZALTE		3.300.00								900.000		45.000
4	Brekcie shpati, Zhavorr, Zhure		138,787.00				886.557		886.557		30.748.880		1.537.444
5	Fe-Ni & Ni-Si	535.128,00		111.800,00	150.158.905		77.560.273	111800	227.719.178	4.255.178	17.018.686		52.264.137
6	Gelq. i Mermeriz.		13.580,78		29.613.772		32.015.391		61.629.163	232.000	191.795.484		2.903.961
7	Gelqeror Pllakor		16.627,40		1.140.072		724.572		1.864.644	67.670	26.935.504,74		1.861.917,75
8	Gips - Alabaster	106.433,40			2.662.600		1.000.000		3.662.600	0	60.335.965		1.907.313,4
9	Gur Gelqeror		3.165.867,18		155.396.041,6		12.283.341,64		167.679.383,3	0	13.831.285.171		177.149.052
10	Krom	683.874,30		3.543.671,7	1.595.496.228	257.546,7	834.815.299,7	3801218,4	2.430.311.528	34.640.615,9	2.473.855.415	2078437	148.431.324,9
11	Kuarc	10.731,00			532.000		282.000		814.000	0	29.483.000		1.474.150
12	Ranor Silicor		13.989,88		2.500.000		77.044.000		79.544.000	27914	117.655.973,4		5.956.898
13	Zhavorr & Rera Bituminoze	116.806,00			39.958.346,4		38.261.139,2		78.219.485,6	0	365.839.754,9		21.950.385,29

14	Traktolite, Efuzive, Ultrabazike		2,000.00		110.029.585		1.020.377		111.049.962	0	240.000		452.107
Shuma				5.409.700, 7	2.146.142.227	967.546,7	1.087.153.759	6.377.247,4	3233295985	63961510,9 2	24.212.299.248	2078437	618.992.771,8

Investimet në Total për vitin 2014 = 35.770.84 USD

Të ardhura nga Renta Minerare për vitin 2014 = 7.706.189USD Kursi i Kembimit: 1 USD = 110 Leke

Tabela 17 - Deklarimet vjetore kalendarike të subjekteve në Shqipëri për vitin 2014
Burimi: AKBN 2014, Volumi I - Deklarimet e subjekteve për 2014

5.1.12 EKSPORTI NAFTËS BRUTO SIPAS DESTINACIONIT NË VITIN 2013

	Eksporti i naftës bruto (Ton)	Eksporti i naftës bruto (000 Lek)
Franca	60.638	3.432.785
Gjermani	66.912	3.766.999
Itali	412.144	22.089.645
Malta	295.476	16.471.439
Spanja	395.613	22.496.252
Britania e Madhe	20.730	1.186.052
Totali	1.251.513	69.443.172

Tabela 18 - Eksporti naftës bruto sipas destinacionit në vitin 2013

Burimi: International Trade Centre (<http://www.intracen.org/itc/market-info-tools/trade-statistics/>)

Komente dhe Analiza: Open Data Albania




Figura 8. Eksporti i naftës bruto

5.1.13 POPULLSIA SIPAS RAJONEVE MINERARE DHE TË HIDROKARBUREVE

	Popullsia		Sipërfaqe (km ²)	Densitet (banorë për km2)	
	Census 2011	Rregjistri Civil		Census 2011	Rregjistri Civil
Fushë Arrëz	7.405	11.651	540,42	13,70	21,56
Bulqizë	32.210	4.223	678,51	47,47	59,28
Patos	22.959	42.738	82,5	278,29	518,04
Pukë	11.069	16.836	505,53	21,89	33,30
Prrenjas	24.906	33.031	322,95	77,12	102,28
Selenicë	18.476	35.793	561,24	32,92	63,77
Has	16.790	21.247	399,62	42,01	53,17
Skrapar	12.403	19.072	831,44	14,92	22,94
Vau i Dejës	30.438	48.966	499,09	60,99	98,11

Tabela 19 - Popullsia sipas rajoneve minerare dhe të hidrokarbureve

Burimi: <http://zgjedhje2015.reporter.al>

5.1.14 STRUKTURA E PUNËSIMIT SIPAS GJINISË DHE AKTIVITETIT EKONOMIK

Industri nxjerrëse, Energji, gaz dhe furnizimi me ujë

	2013		2014	
Gjithsej	2,20%	21.795	2,40%	24.889
Meshkuj	3,40%	18.747	3,60%	21.084
Femra	0,70%	3.048	0,90%	4.062

Tabela 20 - Struktura e punësimit sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik

Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2013,2014 INSTAT

5.1.15 ORËT MESATARE TË PUNËS NË JAVË PËR TË PUNËSUARIT SIPAS GJINISË DHE AKTIVITETIT EKONOMIK

Industri nxjerrëse, Energji, gaz dhe furnizimi me ujë

	2013	2014
Mesatarja e përgjithshme	43,3	42,2
Gjithsej	43,1	43,0
Meshkuj	43,4	43,3
Femra	41,2	41,7

Tabela 21 - Orët mesatare të punës në javë për të punësuarit me pagë sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik

Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2013,2014 INSTAT

5.1.16 PAGA MESATARE MUJORE BRUTO PËR NJË TË PUNËSUAR, 2014

	2014			
	Mestarja	Meshkuj	Femra	Hendeku gjinor
Mesatarja e përgjithshme	45.539	47.664	42.852	10%
Industri nxjerrëse	106.314	111.400	62.328	44%
Industri përpunuese	29.091	36.214	24.772	32%

Tabela 22 - Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas aktiviteteve ekonomike dhe gjinisë, 2014

Burimi: Llogaritje e INSTAT bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave

5.1.17 DEKLARIMET VJETORE KALENDARIKE TË SUBJEKTEVE NË SHQIPËRI PËR VITIN 2014 PËR PUNËSIMIN

Nr	LLOJI I MINERALIT	Nr. i Punonjësve
1	Argjilë	49
2	Bakër	235
3	Bazalte	8
4	Brekcie shpati, Zhavorr, Zhure	18
5	Fe-Ni & Ni-Si	86
6	Gëlq. i Mermeriz.	31
7	Gëlqeror Pllakor	35
8	Gips - Alabastër	34
9	Gur Gëlqeror	606
10	Krom	2.955
11	Kuarc	4
12	Ranor Silicor	61
13	Zhavorr & Rëra Bituminoze	134
14	Traktolite, Efuzive, Ultrabazike	10
		4.266

Tabela 23 - Deklarimet vjetore kalendarike të subjekteve në Shqipëri për vitin 2014 për punësimin

Burimi: AKBN 2014




Figura 9. Deklarimet vjetore mbi punësimin

Burimi: AKBN 2014

5.1.18 TREGUESIT SOCIAL EKONOMIK TË RAJONEVE MINERARE PËR RAJONET (CENSUSI 2011)

Rajoni	Popullsia në moshë pune	Papunësia (%)	Papunësia për femra (%)	Papunësia te të rinjtë 15-29 vjeç (%)
Bulqiza	23.085	38,5	37,4	58,76
Fier dhe Lushnje	227.372	24,0	27,0	39,67
Has	11.971	63,1	61,1	78,54
Librazhd	43.664	23,9	21,5	40,61
Puke	13.981	44,1	40,0	67,15
Shkoder e Madhe	154.847	39,0	40,8	55,85
Skrapar	13.580	18,8	20,7	29,23
Vlore e Himare	102.222	27,0	31,9	43,13

Tabela 24 - Treguesit social ekonomik të rajoneve minerare për rajonet (Censusi 2011)

Burimi i informacionit: INSTAT, <http://instatgis.gov.al>

NR.	Bashkitë	Transferta e pakushtëzuar 2016	Transferrat specifike për financimin e funksioneve									Totali
			Konviktet e arsimit parauniversitar	Arsimi parashkollor	Arsimi parauniversitar	Mbrojtja nga zjarri	Mbrojtja sociale	Administrimi i pyjeve	Rrugët	Ujitja dhe Kullimi	Fond për Investime	
1	Bulqizë	196.658	0	48.370	0	8.269	0	2.453	27.453	5.227	0	288.429
2	Fushë Arrëz	66.272	0	23.408	3.714	0	0	3.679	12.866	2.198	0	112.137
3	Has	108.340	6.481	25.385	2.321	8.962	0	3.066	1.527	2.198	0	158.280
4	Patos	95.542	0	38.441	2.786	8.764	0	0	1.728	2.814	0	150.075
5	Prrenjas	117.256	0	29.137	2.321	0	0	2.453	17.581	2.198	0	170.946
6	Pukë	82.123	13.174	30.674	5.571	11.512	0	3.679	6.159	2.198	0	155.090
7	Selenicë	129.843	0	18.544	4.178	0	0	613	2.620	5.227	0	161.02

												5
8	Skrapar	104.520	10.673	38.683	3.714	7.846	0	1.226	12.054	2.198	0	180.91
9	Vau i Dejës	154.016	8.400	21.893	1.857	0	0	1.840	5.440	4.046	0	197.49

Tabela 25—Transferta e pakushtëzuar dhe specifike për bashkitë për vitin 2016 (në 000/lekë)

Burimi: Ministria e Financave, <http://www.financa.gov.al/>

5.2 BASHKIA E BULQIZËS

5.2.1 PËRSHKRIM I SHKURTËR



Rrethi i Bulqizës shtrihet në pjesën lindore të Republikës së Shqipërisë dhe kufizohet, në lindje me Dibrën e Madhe (në Maqedoni), në veri me Rrethin e Dibrës, në perëndim me Rrethin e Matit dhe Rrethin e Tiranës dhe në jug me Rrethin e Librazhdit. Qendër administrative e rrethit është qyteti i Bulqizës.

Përgjithësisht relievi është me terren të thyer malor me lartësi që shkojnë nga 420 m deri 2101 m. Në këtë

territor shtrihen Lugina e Bulqizës me shtrirje nga perëndimi në lindje me gjatësi 25 km e gjërësi deri 1 km, që fillon në perëndim me Qafën e Buallit në lartësinë 842 m, ku kalon rruga automobilistike që lidh Burrelin me Bulqizën, Peshkopinë e Dibrën e Madhe. Kjo luginë përshkohet nga Zalli i Bulqizës që derdhet në Drinin e Zi. Në këtë rreth gjenden edhe Lugina e Okshtunit që përshkohet nga Zalli i Okshtunit deri sa bashkohet me Zallin e Bulqizës në Çerenec; Lugina e Zogjes; Lugina e Martaneshit; Rrafshnalta e Gollobordës; Fusha e Gjoricës; Fusha e Homeshit; Fusha e Vajkalit; Fusha e Klenjës dhe Fusha e Ballenjës. Toka bujqësore më pjellore njihen Fusha e Gjoricës dhe Fusha e Homeshit. Bujqësia është mjaft e prapambetur për shkak të mungesës së mekanizimit të punimeve dhe të formave të përparuara të shfrytëzimit të tokës edhe në terrenin e thyer ku gjendet pjesa më e madhe e tokës së punueshme.

Në territorin e rrethit të Bulqizës janë edhe malësia e Martaneshit dhe e Gollobordës që kanë pamjen e një pllaje të valëzuar që rrethohen nga male të lartë. Lartësia më e madhe është në jug të maleve të Allamanit Maja e Kreshtës (2101m) dhe në malet e Lopës, Maja e Dhokzit (2020m) dhe maja e Kaptinës (1873m).

Në Bulqizë dhe në Krastë gjenden vendburimet më të mëdha në Shqipëri të mineralit të kromit, që bashkë me 36 mijë ha me pyje të pishës e të ahut, që përbëjnë bazën kryesore të zhvillimit ekonomik të rrethit.

Klima në gjithë rrethin e Bulqizës është kontinentale e ftohtë në dimër dhe e thatë në verë. Lugina e Bulqizës duke qenë e hapur nga lindja, përshkohet shumë nga erërat. Temperatura mesatare vjetore arrin vlerën 10°C dhe temperatura maksimale është regjistruar deri 35°C në verë e ajo minimale –18°C në dimër. Sasia mesatare e reshjeve të një viti arrin në 980 mm.

Historikisht rrethi i Bulqizës përbëhet nga një popullsi autoktone e vendosur në gjashtë krahina: Bulqiza, Gryka e Madhe, Gryka e Vogël, Okshtuni, Martaneshi dhe Golloborda.

5.2.2 POPULLSIA

Sipas Censusit të vitit 2011 ka një popullsi prej 32,210 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki numëron 40,223 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 678.51 km² me një densitet prej 59.28 banorë/km² sipas Regjistrit Civil dhe 47.47 banorë/km² sipas Censusit 2011.

Bashkia Bulqizë ka në përbërje 8 Njësi Administrative, të cilat janë: Bulqizë, Martanesh, Fushë-Bulqizë, Zërqan, Shupenzë, Gjoricë, Ostren dhe Trebisht. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e

rrethit të Bulqizës dhe qarkut të Dibrës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Bulqiza dhe Krasta) dhe 63 fshatra.

5.2.3 SHOQËRIA CIVILE

Aktiviteti i shoqërisë civile mbulohet nga organizata me karakter kombëtar ose rajonal.

5.2.4 NJËSITË ADMINISTRATIVE

Bashkia Bulqizë

Njësitë Administrative	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Bulqizë	"Qyteti Bulqizë, Fshatrat: Vajkal nr1, Vajkal nr 2".
Martanesh	"Qyteti Krastë, Fshatrat: Gjon, Lenë, Peshk, Val, Stavec, Mëlçu, Ndërfushas".
Fushë-Bulqizë	"Fshatrat: Fushë - Bulqizë, Dushaj, Dragua, Koçaj".
Zerqan	"Fshatrat: Zerqan, Krajë, Peladhi, Smollik, Sofraçan, Sopot, Strikçan, Tërnovë e Madhe, Tërnovë e Vogël, Valikardhë, Zall-Sopot, Zall-Strikçan, Godvi".
Shupenzë	"Fshatrat: Shupenzë, Vlashaj, Boçevë, Homesh, Okshatinë, Kovashicë, Zogjaj, Shtushaj, Topojan, Mazhicë, Gjuras, Bllacë".
Gjoricë	"Fshatrat: Gjoricë e Sipërme, Gjoricë e Poshtme, Çerenec i Sipërm, Çerenec i Poshtëm, Viçisht, Lubalesh".
Ostren	"Fshatrat: Ostren i Madh, Radovesh, Kojavec, Lejçan, Orzhanovë, Okshtun i Madh, Oreshnjë, Okshtun i Vogël, Ostren i Vogël, Tuçep, Lladomericë, Pasinkë, Tërbaç".
Trebisht	"Fshatrat: Klenjë, Gjinovec, Trebisht- Balaj, Trebisht- Çelebi, Trebisht- Mucinë, Vërnice".

5.2.5 STATISTIKA SOCIAL - DEMOGRAFIKE TË RAJONIT

		Popullsia		Siperfaqe	Densitet (banore per km2)	
		Census 2011	Rregjistri Civil		Census 2011	Rregjistri Civil
Bulqize		31.210	40.223	678,51	46,00	59,28

Tabela 26 - Statistika social - demografike të rajonit

Burimi: <http://zgjedhje2015.reporter.al>

5.2.6 TREGUESIT GJENERIK TË SEKTORIT TË MINERALEVE NË RAJONIN E BULQIZËS PËR 2014

Rajoni	Rezerva minerare (Ton)	Investimi (Lekë)	Prodhimi (Ton)	Qarkullimi (Lekë)	Punësimi	Kontributi i rentës (Lekë)
Bulqizë	2.005.850,2	1.296.815.755	435,615	1.642.556.422	2.276	114.226.936

Tabela 27 - Treguesit gjenerik të sektorit të mineraleve në rajonin e Bulqizës për 2014

Burimi: Raporti AKBN 2014

5.2.7 LISTA E KOMPANIVE QË VEPROJNË NË RAJONIN E BULQIZËS

Nr.	Nr. i lejes	Datë	Emri isubjektit	Rrethi	Lloji i Mineralit	Administratori
5	253	01.04.1996	Xhiretone	Bulqize	Krom	Enton Zajmi
11	308	17.07.1996	Diani	Bulqize	Krom	Genc Çuka
22	469	02.08.1999	Tadri	Bulqize	Krom	Tahir Gjoka
23	475	02.08.1999	Albanisa Krypi	Bulqize	Krom	Pellumb Perkola & Flamur Krypi
24	476	02.08.1999	Koka	Bulqize	Krom	Rakip Koka
25	477	02.08.1999	Besa	Bulqize	Krom	Besim Plloçi
26	478	02.08.1999	Bledi	Bulqize	Krom	Petrit Kenga
27	479	02.08.1999	Xhiretone	Bulqize	Krom	Asim Zajmi
28	480	02.08.1999	Dervishi	Bulqize	Krom	Ndriçim Dervishi
29	481	02.08.1999	Alb - Canaj	Bulqize	Krom	Urim Canaj
30	483	02.08.1999	Zguri	Bulqize	Krom	Rexhep Zguri
31	484	02.08.1999	Ylberi	Bulqize	Krom	Ylber Doda
32	486	02.08.1999	Ral	Bulqize	Krom	Ramazan Rrushi

33	487	02.08.1999	Vileda	Bulqize	Krom	Vera Stafa
34	488	02.08.1999	Klosi	Bulqize	Krom	Nazif Klosi
35	489	02.08.2009	Ervini	Bulqize	Krom	Sulejman Kurti
36	492	02.08.1999	Herbi	Bulqize	Krom	Bajram Lleshi
37	493	04.08.1999	Dialba	Bulqize	Krom	Gani Hoxha
38	494	04.08.1999	Geri-Trevi	Bulqize	Krom	Agim Cuka
43	506	04.08.1999	Diani	Bulqize	Krom	Genc Çuka
44	507	04.08.1999	Ylberi	Bulqize	Krom	Ylber Çupi
45	516	08.09.1999	Krasta	Bulqize	Krom	Abdyl Demiri
46	523	05.10.1999	Min-Ex	Bulqize	Krom	Veli Meçaj
47	531	21.12.2009	Ra-Krom Tirana	Bulqize	Krom	Gani Hoxha
48	536	05.01.2000	Kurti	Bulqize	Krom	Gezim Porja
49	539	17.02.2000	Teodori	Bulqize	Krom	Faik Teodori
50	545	03.04.2000	Kurti	Bulqize	Krom	Gezim Porja
58	579	01.11.2000	Eternal Security	Bulqize	Krom	Lahim Gjika
62	583	14.11.2000	Lita Brother Construction	Bulqize	Krom	Gazmend Lita
63	584	07.12.2000	Koxherri	Bulqize	Krom	Fatos Doda
65	589	26.12.2000	Shkembi	Bulqize	Krom	Veli Losha

69	607	15.03.2001	Cani-1	Bulqize	Krom	Sokol Lika
72	611	16.03.2001	Ivno 1100	Bulqize	Krom	Gentian Keta
87	677	16.09.2002	AlbChrome	Bulqize	Krom	Edmond Xhafa
88	677/1	16.09.2002	Marei	Bulqize	Krom	Zeqir Çali
98	718/1	20.08.2003	Rakipi	Fier	Rera Bituminoze	Mynyr Rexhepaj
107	755	14.03.2004	11 Heronjte Bater	Bulqize	Krom	Dhurim Kurti
116	775	02.07.2004	Koka	Bulqize	Krom	Rakip Koka
117	777	21.07.2004	Kejsi	Bulqize	Krom	Shefki Beta
119	787	06.08.2004	Ral	Bulqize	Krom	Ramazan Rrushi
127	809	01.10.2004	Teodori	Bulqize	Krom	Faik Teodori
128	810	04.10.2004	Dushi	Bulqize	Krom	Admir Koka
139	858	11.05.2005	Krasta	Bulqize	Krom	Abdyl Demiri
144	869	17.06.2005	Arkev	Bulqize	Krom	Ali Merkuri
149	880	24.06.2005	Fab. E Pasurimit te Cr. Bulqize	Bulqize	Krom	Bukurosh Koçi
152	885	07.07.2005	Fab. E Pasurimit te Cr. Bulqize	Bulqize	Krom	Bukurosh Koçi
153	886	07.07.2005	Fab. E Pasurimit te Cr. Bulqize	Bulqize	Krom	Bukurosh Koçi
157	892	27.07.2005	Fabrika e Pasurimit te Kromir Bulqize	Bulqize	Krom	Bukurosh Koçi

158	893	27.07.2005	Neli	Bulqize	Krom	Isuf Neli
173	934	13.04.2006	Gentari	Bulqize	Krom	Gentian Keta
178	946	17.07.2006	Dushi	Bulqize	Krom	Admir Koka
179	949	18.07.2006	Lena - 1	Bulqize	Krom	Qazim Lena
183	957	28.08.2006	Beni - 06	Bulqize	Krom	Artur Bruci
191	975	10.10.2006	Erim	Bulqize	Krom	Ismail Shyti
195	982	20.12.2006	Algej	Bulqize	Krom	Shyqyri Kenga
207	1030	03.07.2007	Algri	Bulqize	Krom	Kujtim Alstafa
208	1032	03.07.2007	Kuinxhiu	Bulqize	Krom	Veli Kuinxhiu
222	1069	28.08.2007	Bimi	Bulqize	Krom	Ibrahim Bami
226	1082	06.11.2007	Pakti	Bulqize	Krom	Oltjan Kala
228	1088	19.11.2007	Egi -K	Bulqize	Krom	Eduart Keta
238	1121/1	16.05.2012	Kujtim & Lena	Bulqize	Krom	Kujtim Lena
243	1140	28.01.2008	Ylberi	Bulqize	Krom	Ylber Doda
245	1155	03.03.2008	Egi -K	Bulqize	Krom	Eduart Keta
247	1163/1	20.07.2012	Klervi - Bris	Bulqize	Krom	Adrian Hida
252	1076/1	04.04.2013	Nag-3	Bulqize	Krom	Albert Koxheri
254	1181	15.04.2008	Geri's 2002	Bulqize	Krom	Ilger Qose

258	1197	01.07.2008	Durici	Bulqize	Krom	Hysen Durici
265	1214	21.07.2008	Isaku	Bulqize	Krom	Edmond Isaku
270	1231	15.08.2008	Bledi	Bulqize	Krom	Petrit Kenga
282	1259/2	21.05.2014	Alb - Soni	Bulqize	Ni-Si, Krom	Tahir Osmani
283	1265/2	10.03.2014	Zeneli	Bulqize	Krom	Besmir Sula
284	1269	30.10.2008	Kurti - A	Bulqize	Krom	Arben Kurti
287	1279	17.12.2008	Gerda	Bulqize	Krom	Lulzim Veçishta
288	1281	17.12.2008	Gentari	Bulqize	Krom	Gentian Keta
289	1282/1	18.12.2008	Drini Bulqize	Bulqize	Krom	Ilir Cami
290	1283	18.12.2009	Klervi - Bris	Bulqize	Krom	Ardian Hida
294	1294	19.12.2008	Tollja	Bulqize	Krom	Ardit Tollja
295	1295	26.12.2008	Ylberi	Bulqize	Krom	Ylber Doda
296	1296	30.12.2008	Ardas	Bulqize	Krom	Xhafer Ndreu
297	1297	30.12.2008	Aki-Leo	Bulqize	Krom	Veli Meçaj
304	1326	21.02.2009	Gjoni	Bulqize	Krom	Jashar Gjoni
305	1328	17.03.2009	Buna-Mat	Bulqize	Krom	Agim Hysa
326	1362	09.06.2009	Kaprolla	Bulqize	Krom	Qamil Hidri
327	1365	04.06.2009	Comercir	Fier	Rera Bituminoze	Apostol Qirko

347	1409	01.09.2009	Naim & Mealdi	Bulqize	Krom	Naim Kenga
351	1419	11.09.2009	Alb leaa Internacional	Bulqize	Krom	Lefter Alla
353	1423	11.09.2009	Ervini	Bulqize	Krom	Sulejman Kurti
358	1442	21.10.2009	Mara 2011	Bulqize	Krom	Bruno Mara
359	1443	21.10.2009	Mara 2011	Bulqize	Krom	Bruno Mara
366	1459	03.03.2010	Egi -K	Bulqize	Krom	Eduart Keta
367	1460	03.03.2010	Egi -K	Bulqize	Krom	Eduart Keta
368	1461	03.03.2010	Egi -K	Bulqize	Krom	Eduart Keta
370	1465	16.04.2010	Aris	Bulqize	Krom	Adrian Rama
371	1466	16.04.2010	Rami	Bulqize	Krom	Genti Keta
382	1482	20.07.2010	Zasha	Bulqize	Krom	Adrian Rama
383	1483	21.07.2010	Kevger	Bulqize	Krom	Eltjon Deda
384	1485	28.07.2010	Geri's 2002	Bulqize	Krom	Ilger Qose
387	1489	02.08.2010	Brisel	Bulqize	Krom	Rrahim Dedja
388	1490	17.08.2010	Ardas	Bulqize	Krom	Xhafer Ndreu
396	1497	10.09.2010	Global Interprise group	Bulqize	Krom	Ashim Doma
400	1503	13.09.2010	Brother's Funds & Investments	Bulqize	Krom	Bledar Hasa
413	1531	11.01.2011	Krasta	Bulqize	Krom	Abdyl Demiri

424	1544	13.04.2011	Çupi Group	Bulqize	Krom	Arben Çupi
436	1567	22.06.2012	Valteri Grand	Bulqize	Krom	Besim Valteri
437	1569	26.06.2012	Brunes Krom	Bulqize	Krom	Perparim Koci
439	1575	06.08.2012	Albtani -08 Konstruksin	Bulqize	Krom	Adrian Haslika
447	1590	16.11.2013	Erli-D	Bulqize	Krom	Egert Disha
457	1611	23.01.2013	Ternova Chrome Resources	Bulqize	Krom	Perparim Kuqi
496	1670	06.09.2013	Ra-Krom Tirana	Bulqize	Krom	Gani Hoxha
497	1671	06.09.2013	Fabrika e Pasurimit te Kromir Bulqize	Bulqize	Krom	Bukurosh Koçi
524	1715	17.06.2014	Ballenja	Bulqize	Krom	Xhafer Kunxhiu

Tabela 28 - Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Bulqizës

Burimi: Raporti AKBN 2014

5.2.8TË DHËNA EKONOMIKE TË KOMPANIVE QË VEPROJNË NË ZONËN E BULQIZËS

Emri i subjektit	Lloji i Mineralit	Rezerva	Nr. i Punonjësve	Prodhimi 2014	Te ardhura shitja		Garanci Rehabilitimi	Garanci Investimi	Renta
Xhiretone	Krom	4727	3	260	92030				
Diani	Krom	1250	2	1200	147250				935000
Tadri	Krom	10171	5	1210	105529				720000
Albanisa Krypi	Krom	8800	15	3500	438067				
Koka	Krom	6457	6	8042	994568				6234729
Besa	Krom	8654	5	970	211332				1288500
Bledi	Krom	18376	9	1530		36906800			
Xhiretone	Krom	134879	39	5261	47017				
Dervishi	Krom		11	1280	223304		103252	151776	13398\$
Alb - Canaj	Krom		62	10200	1644606		103252		9867634
Zguri	Krom	9500	10	1200					
Ylberi	Krom		7						
Ral	Krom	21852	11	1375		20782987	154787		1248000
Vileda	Krom		3	520					
Klosi	Krom		44	8698	909816				
Ervini	Krom	10596	6	820	214954				1400000

Herbi	Krom	105170	54	12450		133182000	102000		7880000
Dialba	Krom	38050	27	3380,1		10507000	51626		3997720
Geri-Trevi	Krom	19179	9	2310	199918				742000
Diani	Krom	10825	5	1790	273610				1727414
Ylberi	Krom		7	1623			51686		800252
Krasta	Krom	27223	2	1800	89654				547368
Min-Ex	Krom		5	600	60000				
Ra-Krom Tirana	Krom		50	7850		106935385			
Kurti	Krom	79000	9	3000		262500000			
Teodori	Krom		4	400					
Kurti	Krom	35200	27	8700		26110000			
Eternal Security	Krom		8	630					
Lita Brother Construction	Krom	3900	36	4930		30562746	120461	16580	1793672
Koxherri	Krom	138471	5	1800			107000	41980	
Shkembi	Krom	63882	6	1600	104160		57000		634200
Cani-1	Krom		5	708	131017				
Ivno 1100	Krom		17	800					
AlbChrome	Krom		605	67655					

Marei	Krom	25913		27466					
Rakipi	Rera Bituminoze		2						
11 Heronjte Bater	Krom	16440	40	9300	537204		63058		3646613
Koka	Krom	7548	3	6497	903000				3215970
Kejsi	Krom	4400	7	430			31770	20000	
Ral	Krom	26711	3	850		1218960	29792		73138
Teodori	Krom		3	400					
Dushi	Krom	18300	3	200					
Krasta	Krom	59759	7	6950	193561				1184725
Arkev	Krom	13240	4	1550	12400				
Fab. E Pasurimit te Cr. Bulqize	Krom	214152	5	1725		10194000			
Fab. E Pasurimit te Cr. Bulqize	Krom	59476	5	2320		10079000			
Fab. E Pasurimit te Cr. Bulqize	Krom	9557	5	2180		30535000			
Fabrika e Pasurimit te Kromir Bulqize	Krom		2	213,3		255327000			19504000
Neli	Krom		17				51340		
Gentari	Krom		15	5700	546000				
Dushi	Krom	18600	4	300					

Lena - 1	Krom	28761	5	1050			250000	7900	
Beni - 06	Krom		4	1000	134420		27080000		8800000
Erim	Krom		4	210					
Algej	Krom	17060	9	1200					
Algri	Krom		4	400					
Kuinxhiu	Krom	5150	5	200		600000			
Bimi	Krom	23995	5	600					
Pakti	Krom		37	6656		169764920			
Egi -K	Krom	1597	2	875	343427		80373		20605\$
Kujtim & Lena	Krom	12500	8	600					
Ylberi	Krom		10	1350		92720000			
Egi -K	Krom	6724	20	4764	958141		24295		57489\$
Klervi - Bris	Krom		23	8791,5		139221000			
Nag-3	Krom	5508	4	560					
Geri's 2002	Krom	44500	16	820					
Durici	Krom	11995,2	5		150000				
Isaku	Krom	27330	65	10043	105340		36000000	4200000	6320400
Bledi	Krom	15600	5	508					

Alb - Soni	Ni-Si, Krom								
Zeneli	Krom		4						
Kurti - A	Krom		11	560		2592406			
Gerda	Krom	7250	31	1520	162000		18256	265000	
Gentari	Krom			400					
Drini Bulqize	Krom			4711		90743962			
Klervi - Bris	Krom		16	1800		800000			
Tollja	Krom		9	3000		60286473			
Ylberi	Krom		10	1200		22800000			
Ardas	Krom	6600	4	300			1233921		
Aki-Leo	Krom		11	3050					2315978
Gjoni	Krom	10095	14	6280	1296498				8424544
Buna-Mat	Krom			300					
Kaprolla	Krom	21418		2520	496747		26000		3212400
Comercir	Rera Bituminoze		2	31997		17411100			
Naim & Mealdi	Krom	22500	6	600					
Alb leaa Internacional	Krom	19992	66	7857	1597275,72		32499	5000\$	
Ervini	Krom	12884	2						

Mara 2011	Krom	11110	10	1894	396900				
Mara 2011	Krom	17000	13	2686	564060				
Egi -K	Krom	722	2	199			37554		
Egi -K	Krom	66740	47	7783	851267		21737		51076\$
Egi -K	Krom	1597	3	875	343427		80373		20605\$
Aris	Krom	90340	62	7000	1209203		43332		7461000
Rami	Krom	4200		350					
Zasha	Krom	41554	72	11468	1435928		43474		10251679
Kevger	Krom		57	5346		94277459			
Geri's 2002	Krom	25784	16	5090	436447				
Brisel	Krom	28257	155	18534	3109000				
Ardas	Krom	6600	12	3000			32600	600000	
Global Interprise group	Krom			9785			86200	100000	
Brother's Funds & Investments	Krom		5						
Krasta	Krom	98804	3	200			23700	1387000	
Çupi Group	Krom		35	14420	1915000				
Valteri Grand	Krom		3	410		8017276			
Brunes Krom	Krom		7	570					

Albtani -08 Konstruksin	Krom	81425	6	600					
Erli-D	Krom		5	1000					
Ternova Chrome Resources	Krom		5	4000					
Ra-Krom Tirana	Krom					2400000	41300	846000	
Fabrika e Pasurimit te Kromir Bulqize	Krom		4	420			75000		
Ballenja	Krom		3	89					

Tabela29 - Të dhëna ekonomike të kompanive që veprojnë në zonën e Bulqizës

Burimi: Raporti AKBN 2014

5.2.9 REZERVAT E MINERALIT TË KROMIT TË MASIVIT BATËR BULQIZË

Vendburimi	Rezerva në ton
Zona D	54.160
Qafë Buall	1.504.000
Batër	730.264
Theken	652.320
Fushë Lopë	108.866
Liqeni i Sopeve	31.069
Maja e Lugut	277.097
Lugu i Gjatë + 10 Korriku	133.850
Krastë + Lugu i Thellë	2.564.137
TOTALI	10.080.507

Tabela 30- Rezervat e mineralit të Kromit të masivit Batër Bulqizë

Burimi: "Zhvillimi i qendrueshëm i veprimtarive minerare në Shqipëri" - Sokol MATI

5.3.1 PËRSHKRIM



Bashkia e re e Patosit kufizohet në veri dhe perëndim me bashkinë Fier, në jug me bashkinë Mallakastër dhe në lindje me bashkinë Roskovec. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Patosi.

Qyteti i Patosit përfshihet në rrethin e Fierit. Ai është qyteti i dytë më i madh pas Fierit, për nga numri i banorëve, në Qarkun e Fierit. Qyteti i Patosit ndodhet në juglindje të qytetit të Fierit, në rrugën kombëtare Fier-Tepelenë. Një

Qytezë industriale e krijuar rreth vitit 1949 për të strehuar punëtorët dhe inxhinierët që punësoheshin në të quajturën "zona Patos-Marinëz" (një nga zonat më të pasura me naftë të Shqipërisë). Patosi është kryeqendra e industrisë së nxjerrjes së naftës në Shqipëri.

5.3.1.1 GJEOGRAFIA

Patosi ndodhet 7 km në jugperëndim të qytetit të Fierit i shtrirë përgjatë vargut kodrinor cili ndan Fushën e Myzeqesë nga lugina e lumit Gjanica. Ky varg kodrinor vazhdon në formë harku përgjatë rrugës Patos-Fier duke përngjarë me një amfiteatër natyror. Ai është pjesë e kodrave të Mallakastrës së poshtme të cilat vazhdojnë drejt Jugut deri në lumin Vjosë. Sipërfaqja është 82,55 km².

Lartësia mesatare e tyre është rreth 200-300 m e cila vjen duke u ulur drejt Patosit derisa zhyten në fushën e Myzeqesë. Pika më e lartë e rajonit ndodhet në kodrën e Margëlliçit me kuote 320 m mbi nivelin e detit. Përpara qytetit drejt veriut dhe veri-perëndimit shtrihet fusha e Myzeqesë ndërsa drejt veri-lindjes fusha e Roskovecit.

Sipërfaqja sipas relievit ndahet në : Fushore 718 ha dhe Kodrinore 1488 ha. Pranë qytetit degëzohen rruga Fier-Gjirokastrë dhe Fier-Berat të cilat kanë ndikuar në shtrirjen dhe zhvillimin e rajonit. Klima është tipike mesdhetare, me dimër të butë dhe të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Kjo situatë ndikohet nga masat ajrore detare për shkak të distancës relativisht të shkurtër nga deti Adriatik (rreth 25 km).



Nga ana lindore dhe jugore, vargmalet e larta e pengojnë depërtimin e klimës së ftohtë kontinentale. Temperatura mesatare vjetore luhet në 14-15 °C ndërsa temperatura e Janarit rreth 5 °C. Reshjet bien kryesisht në formë shiu ndërsa dëbora është dukuri e rrallë.

Gjatë verës bien vetëm 1/10 e reshjeve vjetore gjë që shtron nevojën e ujitjes së tokave bujqësore. Për këtë arsye janë ndërtuar disa liqene artificiale si ujëmbledhësi i Zharrzës, Lalarit,

Rrozhdies etj.

5.3.1.2 KULTURA DHE SPORTI

Skuadra e futbollit e qytetit quhet "Albpetrol", e cila arritjen më të mirë ka daljen në finalen e kupës së Shqipërisë me skuadrën "Partizani" në sezonin 93'- 94', si dhe pjesëmarrjen në kupën e kupave të Evropës në sezonin 94'- 95'.

5.3.1.3 EKONOMIA

Qyteza e Patosit nisi të ndërtohej rreth vitit 1949 për të strehuar punëtorët dhe inxhinierët e naftës. Baseni naftëmbajtës i njohur si "Patos-Marinza" është historikisht zona më e pasur me naftë në Shqipëri dhe sot vijon të prodhojë shumicën dërrmuese të naftës bruto në vendin tonë. Por pavarësisht kësaj, numri i të punësuarve në industrinë e naftës nga kjo zonë është sot shumë herë më i ulët se sa ka qenë dikur.

Për shumë vite burimi kryesor ekonomik ka qenë sektori naftënxjerrës, por pasi kanë nisur operimin në tregun e naftës kompanitë e huaja niveli i të punësuarve në këtë sektor ka ndryshuar, duke sjellë një përqendrim gjithnjë e më të madh tek sektori i bujqësisë dhe agrikulturë. Sipas të dhënave tashmë, përveç ish komunës Zharrës, zonat e tjera si Patosi dhe Ruzhdia kanë si burim kryesor ekonomik kultivimin e ullirit dhe tregtimin e nënprodukteve të tij, të cilat favorizohen dhe nga vetë relievi kodrinor i kësaj zone.

Më tej është sektori privat i shërbimeve ai që siguron të ardhurat për zonën urbane dhe vitet e fundit kanë nisur aktivitetin në këtë njësi vendore edhe bizneset fasone. Për shkak të relievit malor, në këtë bashki ka zona të largëta me qendrën e bashkisë, popullsia e tyre është reduktuar ndjeshëm për shkak të zhvendosjes drejt qendrave urbane të vendit ose drejt vendeve fqinje. Vitet e fundit, infrastruktura rrugore e zonës urbane dhe fshatrave përreth është përmirësuar ndjeshëm, por sigurisht ka ende shumë punë për t'u bërë në mënyrë që të sigurohet transporti sa më i lehtë i zonave të largëta malore drejt qendrës së bashkisë.

Shtrirja gjeografike e Patosit dhe zgjerimi i kësaj njësie vendore sigurisht që i bën më të mëdha sfidat për pushtetin vendor - bashkinë, duke gërshetuar nevojën për përmbushjen e problematikave të qytetit të Ballshit dhe atyre të zonave rurale përreth tij.

Një nga problemet kryesore të identifikuara më shpesh nga banorët e kësaj zone lidhet me mbështetjen nga ana e bashkisë së kushteve për tregtimin e produkteve të tyre, kryesisht ullirit dhe vajit të ullirit. Promovimi i këtyre produkteve karakteristike për zonën, sigurisht që do të bënte që edhe sipërfaqet e mbjella të shtoheshin, por edhe ekonomia do të rritej.

Një ndër sfidat më të rëndësishme me të cilat përballlet qeverisja vendore është dhe pastrimi dhe rehabilitimi i shumë nga zonave të braktisura naftënxjerrëse, si dhe marrja e masave për parandalimin e ndotjeve nga pushtet ekzistues. Në këtë kuadër, banorët e kësaj bashkie kane identifikuar si sfidë dhe rolin më të mirë bashkërendues të marrëdhënieve mes pushtetit vendor dhe kompanisë koncesionare që shfrytëzon fushën naftëmbajtëse.

Gjithashtu, një sfidë tjetër me të cilën do të përballlet qeverisja vendore - bashkia është lëvrimi nga pushteti qendror dhe miradministrimi i rentës minerare nga nxjerrja e naftës në këtë zonë, nga të cilat bashkia mund të sigurojë të ardhura prej miliona eurosh. Transparenca dhe mirëmenaxhimi i këtyre të ardhurave shërbejnë si një mekanizëm për përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve të kësaj bashkie.

Një ndër sfidat e tjera të identifikuara nga komuniteti i kësaj zone lidhet me ngritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së godinave arsimore të zonës, çerdhe, kopshte dhe shkolla, të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së arsimit në zonë.

Një aspekt tjetër që kërkon vëmendjen e pushtetit vendor është dhe rritja e numrit të familjeve të pastreha gjatë viteve të fundit, në mbështetje të të cilave duhen parashikuar dhe ndërtuar banesa sociale.

5.3.2 POPULLSIA

Sipas Censurit të vitit 2011 bashkia e re Patos ka një prej 22.959 banorësh ndërsa në regjistrin civil rezultojnë banues 42.738 banorë. Territori i bashkisë së re është vetëm 82,5 km². Në bazë të të dhënave të regjistrin civil densiteti i popullsisë është 518 banorë për km² ndërsa në bazë të censurit densiteti i popullsisë është 278,3 banorë për km².

5.3.3 NJËSITË ADMINISTRATIVE

Kjo bashki përbëhet nga 3 njësi administrative, të cilat janë: Patos, Zharëz dhe Ruzhdie. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Fierit dhe qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 18 fshatra.

Bashkia Patos

Njësitë Administrative Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre

Patos	"Qyteti Patos, Fshatrat: Kuqar, Dukas, Rërës, Margëllic, Rusinjë, Griz, Banaj"
Zharëz	"Fshatrat: Zharëz, Fshat i Ri, Frashër, Verbas, Sheqishtë, Belinë"
Ruzhdie	"Fshatrat: Ruzhdie, Siqecë, Gjynaqarë, Drenie, Kasnicë"

5.3.4 SHOQËRIA CIVILE

Aktiviteti i shoqërisë civile mbulohet nga organizata me karakter kombëtar ose rajonal.

5.3.5 STATISTIKA SOCIAL - DEMOGRAFIKE TË RAJONIT TË PATOSIT DHE HARTA E PATOSIT

	Popullsia		Sipërfaqe	Densitet (banorë për km ²)	
	<i>Census 2011</i>	<i>Rregjistri Civil</i>		<i>Census 2011</i>	<i>Rregjistri Civil</i>
Patos	22.959	42.738	82,5	278,29	518,04

Tabela 31 - Statistika social - demografike të rajonit të Patosit dhe harta e Patosit

Burimi: <http://zgjedhje2015.reporter.al>

5.3.6LISTA E KOMPANIVE QË VEPROJNË NË RAJONIN E PATOSIT

Grupi	Shoqëria e liçensuar	Data e marrëveshjes hidrokarbure	Zona e operimit (tokësore)	Faqja e internetit
Shteti Shqiptar	Albpetrol	Gusht 1993	- Patos-Marinza, - Kucova - Ballsh - Karbunare	www.albpetrol.al
Bankers Petroleum Ltd.	Bankers Petroleum Albania Ltd	Korrik 2004	Patos-Marinza,	www.bankerspetroleum.com
	Sherwood International Petroleum Ltd	Shtator 2007	Kuçova	
Stream Oil & Gas Ltd.	Dega ne Shqiperi e Stream Oil & Gas Ltd (Now Transatlantic Petroleum Ltd)	Gusht 2007	- Gorisht-Kocul, - Cakran-Mollaj, - Ballsh-Hekalit - Delvina	www.streamoilandgas.com ; www.transatlanticpetroleum.com
Transoilgroup AG	Transoil Group - Dega ne Shqiperi	Shkurt 2012	Visoka	www.transoilgroup.com
Isuf Berberi – 55% Naim Kasa – 25% Frank Jurgen Weise - 20%	PHOENIX PETROLEUM GAS Sh.a	Gusht 2013	- Amonicë, - Pekish-Muriz, - Frakullë Gaz, - Panaja, - Povelce, - Divjakë, - Ballaj-Kryevdh, - Finiq-Karne, and - Drashovicë	n/a

Emri i subjektit	Nr i lejes	Date	Emertimi i vendburimit	Lloji i Mineralit
Bejleri Alfa	1748	15.04.2015	Patos Fshat, Fier	Rëra Bituminoze

RAKIPI shpk	718	20.08.2003	Kasnicë, Komuna Ruzhdie, Fier (Njoftim revokimi.Prot. MEI 4698,dt. 04.08.2014)	Rëra Bituminoze
Comercir	1356	04.06.2009	Fier, Kasnice Patos	Rëra Bituminoze
Asab	1736	23.12.2014	Patos Zharrez, Fier	Konglomerat

Tabela 32 - Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Patosit

Burimi: Raporti EITI 2012, 2014 dhe AKBN 2014, Volumi II

5.3.7 PROJEKTET E INVESTIMEVE NË KOMUNITETIN E PATOSIT DHE FIERIT (NË USD)

NJVQ	2012	2013	2014
Bashkia Fier	150.000	123.193	57.407
Bashkia Patos	15.850	158.200	62.579
Bashkia Roskovec	20.000	178.000	39.460
Komuna Mbrostar	20.361	264.022	116.627
Komuna Portëz	27.000	141.000	68.919
Komuna Qendër		75.000	77.555
Komuna Zharëz		193.000	129.306
Komuna Kuman	55.500	158.000	92.000
Komuna Bubullimë		93.000	
Komuna Topojë-Seman		14.000	
	288.711	1.397.415	643.853

Tabela 33 - Projektet e Investimeve në komunitetin e Patosit dhe Fierit (në USD)

Burimi: Kompania Bankers – Project Bankers for Communes 2012-2014

5.3.8 MBËSHTETJE KOMUNITETIT NË PATOS NGA BANKERS

Viti	Emri i projektit (Mbështetje komunitetit nga Bankers)	Vlera	Total
2012	Rindërtimi i lulishtes ne lagjen "29 Maji "	\$15.850	\$15.850
2013	Rindërtimi i Parkut te Pensionisteve në Patos	\$13.500	
2013	Blerja e pompave te ujit per Ujesjellesin Patos	\$3.700	
2013	Plani i Pergjithshëm Ndërvendor	\$93.000	
2013	Rindertimi i Pjesshem i stadiumit te Patosit	\$48.000	
			\$158.200
2014	Rindërtimi i këndit sportiv dhe parkut te shkolles "Hekuran Maneku"	\$62.579	\$62.579

Tabela 34 – Mbështetje e komunitetit nga Bankers në Patos

Burimi: Kompania Bankers

5.3.9 BUXHETI I NJËSISË VENDORE QËNDRORE

NJVQ	2012	2013	2014	2015
Patos	80.312.000	71.477.000	84.876.000	89.119.000

Tabela 35 - Buxheti i njësisë vendore qendrore

Burimi: Ministria e Financave, DPD




Figura 10. Buxheti Shtetit për Bashkinë Patos

5.3.10 REZERVAT GJEOLIGJIKE DHE TË PËRDORURA, BAZUAR NË STUDIMET 1985 - 1990 DHE PRODHIMI I AKUMULUAR DERI NË 2014

Fushat naftë-mbajtëse	Formacioni	Rezervat në milion ton		Shkalla e rekuperimit	Prodhimi kumulativ deri ne 2014 në milion ton	Rezervat e rekuperueshme ne 31 Dhjetor 2014
		Gjeologjike	Rekuperuar			në milion ton
Patos-Marineza	Shkëmbinj ranor	258.394	31.120	12%	25.436	5.684

Tabela 36 - Rezervat gjeologjike dhe të përdorura, bazuar në studimet 1985 - 1990 dhe prodhimi i akumuluar deri në 2014

Burimi: Raporti EITI 2013-2014

5.4.1 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM



Zona Gjeografike: Fushë-Arrëzi kufizohet në veri me Bashkinë Tropojë, në perëndim me bashkitë Vau i Dejës dhe jug-perëndim me bashkitë Pukë dhe Mirditë. Në lindje kufizohet me bashkinë Kukës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Fushë-Arrësit.

Bashkia e re ka në përbërje 5 Njësi Administrative: Fushë-Arrëz, Fierzë, Blerim, Qafë-Mali dhe Iballë.

Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Pukës dhe e qarkut Shkodër. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 35 fshatra.

Bashkia Fushë-Arrëz

Njësitë Administrative	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Fushë-Arrëz	"Qyteti Fushë-Arrës, Fshatrat: Fushë-Arrës, Miçaj, Lumëardhe"
Fierzë	"Fshatrat: Fierzë, Porav, Bugjon, Kokdodë, Arst, Miliska, Mëzi, Aprip-Guri"
Blerim	"Fshatrat: Flet, Xeth, Kulumri, Trun, Blerim, Dardhë, Qebik"
Qafë-Mali	"Fshatrat: Qafë-Mali, Armiraj, Srriqe, Mollkuqe, Lajthizë, Lumbardhë, Tuç, Kryezi, Orosh"
Iballë	"Fshatrat: Iballë, Sapaç, Levosh, Berishë e Vogël, Berishë Vendi, Berishë e Sipërme, Shopel, Mërtur"

Burimi: <http://zgjedhje2015.reporter.al>

Bashkia Fushë-Arrëz shtrihet në një zonë malore, me një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore, e cila prej vitesh është dëmtuar nga njerëzit kryesisht për tregti. Mbrojtja e pyjeve kërkon ndërhyrje emergjente.

Bashkia e Fushë Arrëzit është një nga bashkitë më të varfëra në Shqipëri, për shkak të terrenit shumë të thyer malor, rrugëve të këqija dhe mungesës së punësimit.

Pasuritë natyrore të Fushë-Arrëzit, kryesisht ato nëntokësore të shprehura në rezervat e mëdha minerale janë të shumta, ndërsa minierat janë dhënë me koncesion tek firma të ndryshme turke për shfrytëzimin e mineraleve, çka nuk i ka sjellë ndonjë zhvillim kësaj zone. Infrastruktura rrugore në këtë zonë lë shumë për të dëshiruar, pasi pjesa më e madhe e saj është e amortizuar jo vetëm në akset rurale, por edhe në ato nacionale. Ndërsa specifike për këtë zonë është fakti se gjatë muajve të dimrit pjesa më e madhe komunave izolohehen nga dëbora.

Përveç emigrimit drejt vendeve të BE, shumë banorë nga zonat malore të Fushë Arrëzit kanë lëvizur kryesisht drejt kryeqytetit.

5.4.2 POPULLSIA

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 7.405 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki numëron 11.651 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 540,42 km², me një densitet prej 21,55 banorë/km² sipas Regjistrit Civil dhe 13,70 banorë/km² sipas Censurit 2011.

5.4.3 STATISTIKA SOCIAL - DEMOGRAFIKE TË RAJONIT

	Popullsia		Sipërfaqe	Densitet (banore per km2)	
	Census 2011	Rregjistri Civil		Census 2011	Rregjistri Civil
Fushë- Arrëz	7.405	11.651	540,42	13,70	21,55

Tabela 37 – Popullsia dhe densiteti i popullsisë për Fushë-Arrëz sipas Censurit 2011 dhe Regjistrit Civil

Burimi: <http://zgjedhje2015.reporter.al>

5.4.4 LISTA E KOMPANIVE QË VEPROJNË NË RAJONIN E FUSHË- ARRËZ

Nr	Emërtimi i subjektit	Nr. Lejes	Emërtimi i Vendburimit	Data e marrjes së lejes	Lloji i mineralit
1	Beralb Sh.a	1686	Miniera e Bakrit - Fushë-Arrëz	07.02.2014	Bakër
2	Tirex Explor.	1601	Fushë-Arrëz	04.01.2013	Bakër
3	JAB RESOURCES, shpk	1701	Komuna Iballe, Rrethi Pukë, Fushë-Arrëz	23.05.2014	Bakër
4	EDLA , Shpk	1720	Iballë, Rrethi Pukë, Fushë-Arrëz	19.06.2014	Bakër

Tabela 38 – Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Fushë- Arrëz

Burimi: AKBN 2014, Volumi III

5.5.1 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM



Zona Gjeografike: Hasi kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Krumës, i cili u shpall qytet në vitin 1994.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Hasi ka një popullsi prej 16.790 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, ka 21.247 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 399,62 km² me një densitet prej 53,16 banorë/km² sipas të dhënave të

Regjistrimit Civil dhe 42,01 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Kruma, Fajza, Gjinaj dhe Golaj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Hasit dhe të qarkut Kukës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 29 fshatra.

Bashkia Has

Njësitë Administrative	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Krumë	"Qyteti Krumë, Fshatrat: Krumë, Gajrep, Cahan, Mujaj-Dajç, Zahrisht,"
Fajza	"Fshatrat: Fajza, Vranisht, Tregtan, Likeni i Kuq, Metaliaj, Brenogë"
Gjinaj	"Fshatrat: Gjinaj, Pusi i Thatë, Myç-Has, Domaj, Pogaj, Kishaj"
Golaj	"Fshatrat: Golaj, Nikoliq, Bardhaj, Perollaj, Vlahen, Letaj, Peraj, Dobrunë, Zgjeç, Qarr, Helshan, Kosturr"

5.5.2 PROFILI I BASHKISË

Hasi është një zonë që mbijeton falë të ardhurave që vijnë nga emigrimi dhe bujqësia, megjithëse disponon burime të konsiderueshme minerare.

Pasuritë nëntokësore të këtij rajoni kanë nisur të shfrytëzohen në vitet '30 nga italianët. Deri në mesin e viteve '90 ka funksionuar miniera dhe fabrika e pasurimit të bakrit në Golaj, 6 kilometra larg qytetit të Krumës si dhe disa miniera më të vogla, ku ishin të punësuar mbi 3000 punëtorë. Jo vetëm banorët, por edhe specialistët thonë se nëntoka ende nuk është prekur. Për mineralin e bakrit dallohen zona Nikoliq Golaj, Krumë dhe Zahrisht në rrethin e Hasit.

Hasi është një zonë kufitare, ku një pjesë e banorëve kalojnë kufirin rregullisht për punësim apo për arsimim në zonën e Gjakovës në Kosovë, ku gjenden edhe lidhjet historike kulturore dhe ekonomike të krahinës. Relievi i zonës shtrihet nga rreth 300 metra mbi nivelin e detit deri në malet e larta të Gajrepit, Pashtrikut dhe Maja e Kunorës, të cilat gjenden në lartësitë 1400-1900 metra mbi nivelin e detit.

Hasi gjendet gjithashtu në shtegun turistik malor Theth-Valbonë-Kukës dhe turizmi rural apo malor mund të jetë një perspektivë e mirë ekonomike për këtë zonë. Hasi njihet si krahinë etnografike me traditë të gjatë zejtare në produktet e leshit të punuara me shije si dhe për zanatçinj bukëpjekës. Toka bujqësore e disponueshme për banorët e zonës u reduktua ndjeshëm pas ndërtimit të hidrocentralit të Fierzës, i cili përmblyti disa lugina dhe fshatra.

5.5.3 LEJET MINERARE TË SHFRYTËZIMIT RRETHI HAS

Lejet minerare sipas llojit të mineralit rrethi Has:

Lloji i mineralit	Nr. i Lejeve
Bakër	1
Fe-Ni & Ni-Si	2
Krom	21
Gur Gëlqeror	1
Shuma	25

5.5.4 LISTA E KOMPANIVE QË VEPROJNË NË RAJONIN E HASIT

Nr	Nr i lejes	Date	Emri i subjektit	Emertimi i vendburimit	Lloji i Mineralit
1	234	29.12.1995	BLEDI shpk	Qafe Prushit, Nr.3(Ndryshuar administratori me Urdhër Nr.456, dt31.03.2012)	Krom
2	290	01.07.1996	AG.CAHANI shpk	Gajrep (Proces Revokimi Prot. MEI 6065/1, dt 13.11.2014)	Krom
3	291	01.07.1996	NEZA shpk	Perollaj (Proces Revokimi Prot. MEI 6044/1, dt 13.11.2014)	Krom
4	413	27.05.1998	FLORIDA shpk	Qafe Prush 5	Krom
5	645	27.08.2001	VLLAZËRIA MINERAL ALBANIA, Shpk	Qafa e Perrollajt(Ndryshuar emri me A. Mirat.1615, dt 25.02.2013)	Krom
6	687/1	22.05.2013	VELLAZERIA shpk	Obj Krume, rrethi Has, qarku Kukes.	Gur gelqeror
7	769	28.06.2004	NEZA - 2004 shpk	Miniera Vllahen, profili XXV-XXV deri XLII-XLII, Horizonti +650, +700dhe +730	Krom
8	1340	11.05.2009	INFO METAL PLAST -AL, shpk	Bregu i Skatines - dalja1	Krom
9	1346	20.05.2009	ELIDON 06, shpk	Vllahna Lindore	Krom
10	1347	20.05.2009	AFRIMI, shpk	Gajrep	Krom
11	1405	31.08.2009	EMMA CHROM 2011, shpk	Vllahna Veriore, rrethi Has(Trasferuar me Akt-Miratim Nr 1581, Dt.12.10.2012)	Krom
12	1452	22.02.2010	INFO METAL PLAST -AL, shpk	Gjinaj- Domaj	Fe-Ni

13	1468	29.04.2010	CAHANI, shpk	Objekti Gajrep	Krom
14	1492	25.08.2010	VLLAZËRIA MINERALS ALBANIA , shpk	" Livadhi i Kokës ".(Trasferuar me Akt-Miratim Nr. 1614, dt 25.02.2013)	Krom
15	1534	23.02.2011	AFRIMI K, shpk	Objekti Cahan, Vendoset ne afersi te rruges automobilistike Krume-Cahan	Ni-Si
16	1584/1	31.12.2013	BLERIMI KOSTURR-2010 , sh. P. k.	Objekti Zylfaj, Has	Bakër
17	1610	23.01.2013	VELLAZERIA shpk	Objekti Gajrep, krume, Has	Krom
18	1622	03.04.2013	EMMA CHROM 2011, shpk	Objekti kromit "Vlahna" komuna Golaj, rrethi Has, qarku kukes	Krom
19	1629	30.05.2013	BLERIMI KOSTUR 2010;Sh.p.k	Macaj - Perrollaj, rrethi Has	Krom
20	1636	20.06.2013	BLERIMI KOSTUR 2010;Sh.p.k	Kosturr, has	Krom
21	1649	30.07.2013	ILLYRIA MINERALS INDUSTRY, Sh.a	Miniera Vlahën (Proces Revokimi Shkres e MEI, Nr Prot.3281/2, dt.23.07.2014)	Krom
22	1668	06.09.2013	CAHANI, Sh.p.k	Vlahna, Komuna Golaj	Krom
23	1705	23.05.2014	BLERIMI KOSTUR 2010;Sh.p.k	Vlahnë	Krom
24	1721	19.06.2014	BLERIMI KOSTURR 2010, Shpk	Gezhimë, Rrethi Has	Krom
25	1725	10.09.2014	MINING FERRO NIKEL, Sh.p.k	Qafa e Gomurit, Has	Krom

Tabela 39 – Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Hasit

Burimi: AKBN 2014, Volumi III

5.6.1 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM



Zona Gjeografike: Përrenjasi kufizohet në veri me bashkinë Librazhd, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Pogradec dhe në perëndim me Bashkinë Elbasan. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Përrenjasit.

Sipas Censusit të vitit 2011, Përrenjasi ka një popullsi prej 24.906 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 33.031 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 322,95 km². Sipas censusit, densiteti i popullsisë është 77 banorë/km² ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti është 102,279 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Përrenjas, Qukës, Rrajcë dhe Stravaj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Librazhdit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 25 fshatra.

Bashkia Përrenjas

Njësitë Administrative	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Përrenjas	"Qyteti Përrenjas, Fshatrat: Përrenjas-Fshat, Rrashtan"
Qukës	"Fshatrat: Qukës Shkumbin, Qukës Skënderbej, Skroskë, Mënik, Gurrë, Bërzeshtë, Fanjë, Karkavec, Dritaj, Pishkash, Pishkash Veri"
Rrajcë	"Fshatrat: Rrajcë, Sutaj, Skënderbej, Bardhaj, Katjel, Kotodesh, Urakë"
Stravaj	"Fshatrat: Stravaj, Stranik, Farret, Shqiponjë, Sopot"

5.6.2 PROFILI I BASHKISË

Bashkia e re e Përrenjasit përfshin sipërfaqe të shumta pyjore dhe burime të bollshme hidrike si dhe një fushë pjellore. Nëntoka është e pasur me krom, ndërkohë që ky mineral shfrytëzohet aktualisht në dy prej fshatrave të bashkisë së re.

Zonat e Rrajcës, Qukës dhe Stravajt kanë sipërfaqen më të madhe të pyjeve në këtë zonë. Megjithatë, shfrytëzimi pa kriter gjatë dy dekadave të fundit i ka dëmtuar pyjet në një masë të gjerë.

Bashkia e re e Përrenjasit ka një pozicion të favorshëm gjeografik, pasi gjendet fare pranë dy pikave doganore me Maqedoninë. Por ky avantazh nuk është shfrytëzuar deri më sot për nxitjen e sipërmarrjes dhe shtimin e vendeve të punës. Përgjatë tranzicionit, në këtë zonë kanë munguar strategjitë e zhvillimit. E megjithatë, emigracioni në zonën e Përrenjasit nuk ka qenë i lartë. Kjo pasi shumë banorë të zonës kanë zgjedhur punësimin sezonal në Maqedoninë fqinje, me të ardhurat e të cilëve mbijeton një pjesë e mirë e popullatës.

Në të gjithë bashkinë e re rezultojnë të regjistruara 234 biznese, të cilat e kryejnë aktivitetin e tyre kryesisht në shërbime. Një pjesë e vogël e bizneseve merren me kultivimin e troftës.

Bashkia e Përrenjasit ka potenciale të pashfrytëzuara për turizëm natyror. Me historinë e pasur të zonës së Rrajcës, ku ndodhet shkëmbi i Skënderbeut dhe legjenda për Sofrën e tij si dhe me bukuritë natyrore të Sopotit, zona mund të kthehej në një destinacion për vizitorë vendas dhe të huaj.

Etnografia e pasur me këngët dhe vallet karakteristike të zonës do të ndihmonin për këtë qëllim, por mungesa e infrastrukturës rrugore i bën këto resurse të paarrishme nga turistët.

5.6.2.1 FLORA

1857 lloje bimësh spontane, enëzore, të cilat përfaqësojnë 58 % të flora e Shqiptare ose 16 % të florës së Evropës e renditin Librazhdin në një ndër rrethet më të pasura të vendit me bimë të llojeve të ndryshme. Gjenden të gjitha katet bimore dhe mbulesa bimore zë rreth 72 % të territorit të Rrethit të Librazhdit.

5.6.2.2 EKONOMIA

Qyteti i Përrenjasit ka pasuri të shumta minerare e në baze të tyre janë ngritur miniera për përpunimin e tyre si ajo e hekur-nikelit në Përrenjas-Fshat, Miniera e Nikel-Silikatit në Pishkash, e Sektori Minerar i Bushtricës dhe Skroskës.

Në fillim të viteve '90 është zhvilluar dhe sektori privat të të cilën rendësi të madhe kanë bizneset e vogla kryesisht në sektorin e shërbimeve, blegtori, bujqësi gjithashtu dhe në shfrytëzimin e pyjeve.

5.6.3 LISTA E KOMPANIVE QË VEPROJNË NË RAJONIN E PËRRENJASIT

Nr	Nr i lejes	Date	Emri i subjektit	Emertimi i vendburimit	Lloji i Mineralit
1	1307	28.01.2009	Kurum International sha	Librazhd Përrenjas (Proces revokimi prot. MEI, Nr.7007, dt.27.11.2014)	Fe-Ni
2	1335	15.04.2009	Miniera e Kromit Katjel	Librazhd, Katjel, Përrenjas	Krom
3	1614/1	25.04.2014	O.L.I.A	Librazhd Ligata e Merise & Gjashtelise, Rajce, Përrenjas	Krom
4	1673	06.09.2013	Victoria Invest Internacional	Elbasan Katjel, Bashkia Përrenjas, Librazhd	Krom
5	711	10.07.2003	"MINING FERRO NICKEL KATJEL" Sh.p.k	Komuna Rajcë, Përrenjas, Librazhd	Ni - Si
6	771/1	03.12.2014	"KROMOLLARI" Sh.p.k	Komuna Rajcë, Përrenjas	Gur gëlqeror

Tabela 40 – Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Përrenjasit

Burimi: AKBN 2014, Volumi III

5.6.2.2 SPORTI

Futbolli është sporti me i përhapur ne qytetin e Përrenjasit. Klubi i këtij qyteti dhe ekipet e futbollit te grup-moshave të ndryshme mbajnë emrin Domosdova.

5.7 BASHKIA PUKË

5.7.1 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME



Bashkia Pukë është qendra administrative Rrethit Pukë në Qarkun e Shkodrës, e cila shtrihet në një terren të thyer malor në një lartësi 780-850m mbi nivelin e detit.

Zona Gjeografike: Puka kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë e Vaut të Dejës, në lindje me Bashkinë Fushë Arrëz dhe në jug me Bashkitë Mirditë dhe Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është

qyteti i Pukës.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011, Bashkia e Pukës ka 11.069 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 16.836 banorë. Ajo ka një sipërfaqe prej 505,53 km² me një densitet prej 33,30 banorë/km² sipas Regjistrimit Civil dhe 21,89 banorë/km² sipas Censusit 2011.

Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Puka, Gjegjani, Rrapë, Qelëz dhe Qerret. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Pukës dhe e qarkut Shkodër. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 41 fshatra. Lista e plotë e qyteteve dhe fshatrave të kësaj bashkie jepet si më poshtë:

Bashkia Pukë

Njësitë

Administrative

Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre

Pukë	"Qyteti Pukë, Fshatrat: Pukë, Lajthizë"
Gjegjan	"Fshatrat: Dom, Gjegjan, Gojan i Vogël, Rras, Kuzhnen, Gojan i Madh, Shkozë, Kimëz, Kalivare, Mesul"
Rrapë	"Fshatrat: Breg, Rrapë, Kabash, Buhot, Bicaj, Blinisht, Lumzi, Meçe"
Qelëz	"Fshatrat: Qelëz, Bushat, Dushnezë, Midhë, Buzhalë, Dedaj, Levrushk, Ukth, Qerret i Vogël"
Qerret	"Fshatrat: Qerret, Luf, Dush, Karmë, Kçirë, Luf-Plan, Korthpulë, Kaftall, Tejkodër, Gomsiqe, Vrith, Plet"

5.7.2 PROFILI I BASHKISË

Bashkia e Pukës është një ndër zonat e pasura minerare të vendit, e cila disponon gjithashtu një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore. Megjithatë, prerja pa kriter e pyjeve ka shkaktuar jo pak probleme për këtë zonë.

Mbyllja e minierave apo dhënia e tyre me koncesion ka shtuar numrin e të papunëve në Pukë, duke e kthyer varfërinë në një problem akut për banorët e zonës. Për shkak të saj, një pjesë e mirë e popullatës ka migruar në drejtim të Shqipërisë së Mesme ose emigruar jashtë Shqipërisë. Të ardhurat nga emigracioni janë një burim i rëndësishëm mbijetese për këtë bashki.

Prej vitesh në këtë zonë kanë munguar investimet me rëndësi, ndërsa rruga Durrës-Kukës e ka aneksuar dhe izoluar edhe më shumë Bashkinë e Pukës.

Terreni malor i Pukës është shumë i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit malor; krahas pasurive dhe burimeve natyrore me vlera të mëdha ekonomike që gjenden brenda hapësirës gjeografike të Pukës, kryesisht pyje natyrore, bimë mjekësore, pasuri nëntokësore minerare.

Gjatë viteve të fundit, një numër i vogël turistësh janë rikthyer në Pukë për shkak të hapjes së një piste skish dhe ndërtimit të disa haneve. Megjithatë, numri i tyre vazhdon të mbetet i ulët.

Problem për Bashkinë e Pukës vijon të mbetet stina e dimrit, ku bllokimi i rrugëve nga dëbora izolon një pjesë të mirë të zonës dhe vështirëson edhe më shumë jetesën e banorëve.

Aktiviteti minerar privat, në rrethin e Pukës ka filluar në vitin 1995 dhe tani, janë aktive të regjistruara 18 subjekte, nga të cilat 8 leje operojnë në shfrytëzimin e mineralit të bakrit, 6 leje janë për shfrytëzimin e mineralit të kromit, 1 leje për mineralin e kaolinës, 1 leje për material ndërtimor efuziv, 1 leje për traktolite dhe një leje për gur gëlqeror.

Në ish minierat e bakrit Tuç, Qafë Bari, Palucë, Lak Rrosh dhe Fushë – Arrëz, janë dhënë leje minerare për shfrytëzimin e mineralit të bakrit për shoqërinë “Beralb”, sha.

5.7.3 LEJET MINERARE TË SHFRYTËZIMIT RRETHI PUKË

Lejet minerare sipas llojit të mineralit rrethi Pukë

Lloji i mineralit	Nr. i Lejeve
Bakër	8
Kaolinë	1
Krom	6
Gur Gëlqeror	1
Ndërtimor efuziv	1
Troktolite	1
Shuma	18

5.7.3LISTA E KOMPANIVE QË VEPROJNË NË RAJONIN E PUKËS

Nr	Nr. i lejes	Datë	Emri i subjektit	Emertimi i vendburimit	Lloji i Mineralit
1	223	18.12.1995	OSKEOLA, shpk.	Vrrith, Pukë(Transferimi i lejes me Akt- Miratimin Nr.1638, dt 20.06.2013)	Krom
2	411	21.05.1998	FAB. PAS. KROMIT BULQIZE, sh.p.k	Kotece	Krom
3	642	27.08.2001	BERALBA sh.a	Lak Roshi (Ndryshuar sipërfaqia me Urdh. Ministr. Nr 203/23.05.2014)	Baker
4	643	27.08.2001	BERALBA sh.a	Munelle (Ndryshuar sipërfaqia me Urdh. Ministr. Nr. 202/23.05.2014)	Baker
5	1116	13.12.2007	VLLAZNIMI DEDA IMP- EKSP, sh.p.k	Fusha e Madhe - Mali i Terbunit	Krom
6	1312	02.02.2009	OSKEOLA , shpk	Shtraze1 dhe Shtraze2 (Ndryshuar Administr.mr shkr MEI Prot. 1286/1, dt 19.03.2014)	Krom
7	1420	11.09.2009	GRANITI, shpk	Fushe Laje	Traktolite
8	1481	14.07.2010	DONAJ, shpk	Korthpulë, Pukë	Kaoline
9	1555	22.02.2012	BERALB, sh.a	Karma 2, rrethi Puke, qarku Shkoder	Baker
10	1684	07.02.2014	BERALB, Sh.a	Miniera e Bakrit Qaf Bari	Bakër
11	1685	07.02.2014	BERALB, Sh.a	Miniera e Bakrit Tuç	Bakër
13	1687	07.02.2014	BERALB, sh.a	Miniera e Bakrit Palucë	Bakër
14	1689	13.03.2014	BERALB, Sh a	Objekti Munellë	Ndërtimor efuziv
16	1716	09.06.2014	KOKA, shpk	Objekti "Race", Rrethi Puke, Qarku Shkoder	Krom
17	1717	09.06.2014	DRINI-1, shpk	Qerret, Pukë	Gelqeror

Tabela 41 – Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Pukës

Burimi: AKBN 2014, Volumi III

5.7.4 PROJEKTET E INVESTIMEVE NË BASHKINË E PUKËS

Viti	Përshkrim i investimit	Vlera	Investitor
2011	Sistemim asfaltim i rrugës, trotuareve e gjelbërimit Lagjja mbi Muze “Migjeni”	5.700.000 lek	Programi DLDP me mbështetje financiare nga Qeveria Zvicerane
2011	Sistemim asfaltim i rrugë, trotuare e gjelbërimit Lagjja pas 5-katsheve	70.000 USD	Programi UNDP/ART GOLD 2 me mbështetje financiare nga Qeveria Italiane
2011	Investime në Pyje mbjellje Akacie, Geshtenje dhe Arra	8.839.313 lek	Investim nga Buxheti i shtetit
2012	Rikonstruksion i Rruges Kryesore Qyteti Puke, me trotuar, ndriçim, asfalt, lulishte etj	83.596.363 lek	Investuar nga Buxheti i shtetit Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
2012-2013	Blerje kontener për mbetjet Urbane dhe organizimi i skemes Ndervendore të pastrimit	100.000 euro	Programi DLDP me mbështetje financiare nga Qeveria Zvicerane
2012	Reabilitimi i fushes së menaxhimit të mbetjeve urbane në fushën e Qarrit	2.376.156 leke	Programi DLDP me mbështetje financiare nga Qeveria Zvicerane
2012	Rikonstruksion i Rruges së Lajthizes	2.485.197 leke	Bashkia Puke
2012	Rikonstruksion i shkolles 9-vjeçare Migjeni	12 260 911 leke	Buxheti i shtetit Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
2013	Reabilitimi i ish fushes së mbetjeve urbane pranë Stadiumit	300.000 leke	Fondacioni ABC
2013	Rikonstruksion të lagjes tek ish-komisariati	3.370.538 leke	Bashkia Puke
2013	Rikonstruksion i varrezave të Deshmoreve	800.000 leke	Bashkia Puke
2013	Ndertimi i Çerdhës së re për femijë	60.000 dollare	znj. Marjana Graf

Tabela 42 – Projektet e Investimeve në bashkinë e Pukës

Burimi: <http://zgjedhje2015.reporter.al>

5.8.1 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM



Zona Gjeografike: Bashkia e Selenicës kufizohet në veri me bashkinë Fier, në lindje me bashkinë Mallakastër, Tepelenë dhe Memaliaj, në jug me bashkinë Himarë dhe perëndim me bashkinë Vlorë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Selenicës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, zona e bashkisë së re Selenicë ka një popullsi prej 18.476 banorësh ndërsa në Regjistrin Civil rezulton me 35.793 banorë. Dallimi i madh mes shifrave të regjistrit civil dhe të censurit flet për një shkallë të lartë emigrimi. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej

561,24 km². Sipas të dhënave të censurit, bashkia e re ka një densitet prej 32, 9 banorësh për kilometër katror ndërsa sipas regjistrit civil, densiteti është 63, 77 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Selenicë, Armen, Vllahinë, Kotë, Sevaster dhe Brataj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Vlorës dhe qarkut të Vlorës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra.

Bashkia Selenicë

Njësitë Administrative	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Selenicë	Qyteti Selenicë
Armen	"Fshatrat: Armen, Karbunarë, Rromës, Treblovë, Lubonjë, Picar, Mesarak"
Vllahinë	"Fshatrat: Vllahinë, Kocul, Mërtiraj, Rexhepaj, Hadëraj, Mallkeq, Gërnec, Petë, Kropisht, Vezhdanisht, Peshkëpi, Penkovë"
Kotë	"Fshatrat: Kotë, Gumenicë, Hysoverdhë, Lapardha, Mavrovë, Mazhar, Vajzë, Vodicë, Shkallë Mavrovë, Drashovicë"
Sevaster	"Fshatrat: Sevaster, Golimbash, Dushkarak, Shkozë, Mazhar, Ploçë, Lezhan, Amonicë"
Brataj	"Fshatrat: Brataj, Lepenicë, Gjorm, Velçë, Ramicë, Mesaplik, Matogjin, Bashaj, Vërmik, Malas"

5.8.2 PROFILI I BASHKISË

Bashkia e re e Selenicës shtrihet në një zonë kodrinore në bregun e majtë të lumit Vjosa si dhe përgjatë lumit Shushicë, i cili është tributar i Vjosës. Bashkia e re ka në territorin e saj minierën historike të bitumit në Selenicë, ku punësohen edhe banorët e fshatrave përreth, si dhe zonën naftëmbajtëse të Vllahinës ku nafta është drejt shterimit duke lënë pas një zonë të madhe të ndotur.

Bashkia e re përbëhet nga disa komuna të cilat nuk kanë lidhje organike me qytetin e Selenicës, si dhe nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë rrugore me këtë qytet, duke vështirësuar në këtë mënyrë komunikimin mes tyre.

Bujqësia dhe blegtoaria është aktiviteti kryesor ekonomik i bashkisë së re, popullsia e të cilës bazohet veçanërisht shumë te remitancat nga emigracioni për të siguruar të ardhurat e saj.

Si zonë bujqësore, bashkia e re është e lidhur ngushtë me bashkinë e Vlorës, si treg i rëndësishëm për produktet e saj.

5.8.2.1 TË DHËNA MBI MINERALET NË SELENICË

Gjeologjikisht miniera e Selenicës dhe nafta e gazi i kesaj zone janë të lidhura nga ana studimore dhe kërkimore për naftë e gaz mbajtje, përshkrimet gjeologjike fillestare sipas L.Madalena (Sulla geologia di Petroli Albanesi" datojnë që prej vitit 1868 me autor Coquand i cili përshkruan minierën e bitumit të Selenicës shënjat e mjaftueshme të gazit që shfaqen për rreth kësaj zone dhe përfaqë minierës.

Fillimi i shfrytëzimit të vëndburimit të bitumit Selenicë është i hershëm, përpara më tepër se 2000 vjet, por shfrytëzimi i tij në mënyrë të organizuar ka filluar në vitin 1870, kur për herë të parë vëndburimi u dha me konçension një shoqërie Angleze. Në gusht të vitit 1886 konçension i kaloi Bankës Otomane në Konstandinopojë. Në shtator të vitit 1891 konçension i kaloi shoqërisë FRANCEZE të bitumit me qëndër në Paris. Gjat periudhës 1914 -1916, punimet e shfrytëzimit në këtë minierë u ndërpre për shkak të luftës. Gjatë periudhës 1916 -1920 miniera u kontrollua nga ushtria italiane e cila e shfrytëzoi atë.

Në vitin 1920 konçension i kaloi shoqërisë italiane S.I.M.S.A. Nga qershori i vitit 1945 deri në tetor të vitit 1996, miniera u shfrytëzua nga shteti Shqipëtar. Në tetor të vitit 1996, pjesa kryesore e aksioneve (70%) të shoqërisë "Bitumi" sh.a u privatizuan nga VEFA sh.p.k dhe në Shkurt të vitit 2001 aksionet e 8 shoqërisë "Bitumi" sh.a u privatizuan 100 % nga shoqëria Franceze K.L.P. Industries e cila themeloi në Shqipëri sipas të drejtës Shqipëtare shoqërine "SELENICË BITUMI" sh.a e cila aktualisht zhvillon veprimtari minerare nxjerëse dhe përpunuese në vëndburimin e bitumit Selenicë.

Pra, miniera e bitumit Selenicë, ndër vite ka dhënë një kontribut të çmuar në zhvillimin e industrisë minerare në Shqipëri dhe në zhvillimin ekonomik të vëndit. Ajo me historikun e saj reflekton vlera të çmuara historike, vlera të zhvillimit të ekonomisë tregut (kapitalizmit), vlera të lëvizjes greviste dhe vlera të mëdha ekonomike.

Prej muajit Shkurt të vitit 2001 e në vazhdim, pjesa kryesore e vëndburimit ku bën pjesë miniera egzistuese (Pusi vertikal) shfrytëzohet nga shoqëria "Selenicë Bitumi" sh.a e cila është pronare 100 % e aseteve të ish shoqërisë "Bitumi" sh.a (Miniera e bitumit Selenicë) e cila është pajisur me leje shfrytëzimi për nxjerjen e rezervave të bitumit natyral dhe zhavorit bituminoz në një sipërfaqe prej 1.7 km² dhe në vertikallitet nga sipërfaqia deri në thellësi të vëndburimit si dhe nga shoqëria tjetër Franceze "

Mineral Bitumen" sh.p.k e pajisur me leje shfrytëzimi për nxjerjen me karierë të rezervave të bitumit natyral dhe zhavorrit bituminoz (humbjet teknologjike) në zona të shfrytëzuara më parë me punime nëntokësore.

Për shfrytëzimin e vëndburimit mineralar, janë dhënë dhe disa leje të tjera shfrytëzimi me sipërfaqe të kufizuara për nxjerjen e rezervave të mineralit në zona të shfrytëzuara më parë me punime nëntokësore që ndodhen në kufirin jugor të vëndburimit afër sipërfaqes.

Në Shqipëri Miniera e bitumit Selenicë ose shoqëria tregëtare "Bitumi"sh.a është e vetmja që aksionet e saja ka përfshirë të gjitha asetet e minierës (Punimet kapitale minerare, teknologjia nëntokë dhe në sipërfaqe, fabrika e pasurimit, ndërtesat, magazinat, zyrat, fabrika dhe gjithë infrastrukturën tjetër.

5.8.3LISTA E KOMPANIVE QË VEPROJNË NË RAJONIN E SELENICËS

Nr.	Nr i lejes	Data e marrjes së lejes	Emri i subjektit	Rrethi	Emertimi i vëndburimit	Lloji i Mineralit
1	1753	15.05.2015	B\$AD Construction	Vlorë	Selenicë, Vlorë	Zhavorr Bituminoz + Bitum
2	1754	21.05.2015	Beat Generation	Vlorë	Selenicë, Vlorë	Zhavorr Bituminoz + Bitum
3	355	17.06.1997	SELENICE BITUMI , shpk	Vlorë	Selenicë	Zhavor Bituminoz
4	1115	12.12.2007	TILI INERT Sh p k	Vlorë	Resulaj, Selenice	Zhavor Bituminoz
5	594/1	26.01.2012	NACIONAL, shpk	Vlorë	Drashovicë, Vlorë	Gur gelqeror
6	641	16.08.2001	ALBITOIL shpk	Vlorë	Trelove,	Bitum, Rere Bituminoze
7	1496/2	10.07.2013	HEAVY INDUSTRIES, shpk	Vlorë	Trelove, Romes, Vlorë (Shndërrim nga Leje K-Z me Akt- Mirat 1496/2 dt 10.07.2013)	Rere Bitumin.
8	1496/3	20.11.2014	HEAVY INDUSTRIES, shpk	Vlorë	Trelove, Romes, Vlorë (Shndërrim nga Leje K-Z me Akt- Mirat 1496/2 dt 10.07.2013)	Rere Bitumin.
9	1644	02.07.2013	ALB- INDUSTRI, shpk	Vlorë	Selenicë	Zhavor Bituminoz
10	1371	22.06.2009	" MINERAL BITUMI " Sh.p.k	Vlorë.	Selenicë	Bitum & Zhavor Bituminoz

Tabela 43 – Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Selenicës

Burimi: AKBN 2014, Volumi III dhe EITI 2013-2014

5.9.1 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME



Zona Gjeografike: Skrapari kufizohet në veri me bashkinë Gramsh, në perëndim me bashkitë Berat dhe Poliçan, në jug-perëndim me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Përmet dhe në lindje me bashkitë Maliq e Korçë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Çorovodës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 12.403 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej

19.072 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe të konsiderueshme prej 831, 44 km². Sipas censurit, densiteti i popullsisë është 15 banorë/km² ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti është 22, 93 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Çorovodë, Qendër Skrapar, Bogovë, Vëndreshë, Çepan, Potom, Leshnje, Gjerbës dhe Zhepë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Skrapar dhe pjesë e qarkut Berat. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 106 fshatra.

Bashkia Skrapar

Njësitë Administrative	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Çorovodë	Qyteti Çorovodë
Qëndër Skrapar	"Fshatrat: Zogas, Kalanjas, Dhores, Vesesh të, Polenë, Osojë, Grepckë, Liqeth, Rehovicë, Orizaj, Cerovë, Veleshnjë, Nishicë, Sharovë, Çerenisht, Buzuq, Munushtir, Radësh, Koritë, Mollas, Gradec, Vërzhezhë, Slatinjë, Storrë"
Bogovë	"Fshatrat: Bogovë, Kakrukë, Dobrushë, Përparim, Bargullas, Novaj, Nishovë, Jaupas, Selan"
Vëndreshë	"Fshatrat: Lavdar, Spatharë, Therepel, Valë, Vëndreshë e Madhe 1, Vëndreshë e Vogël 2, Vëndreshë e Malit 3, Ibro"
Çepan	"Fshatrat: Çepan, Muzhakë, Rog, Zabërzan i Ri, Zabërzan, Blezënckë, Malind, Muzhënckë, Sevrani i madh, Sevrani i Vogël, Qeshibes, Strënc, Kakos, Prishtë"
Potom	"Fshatrat: Potom, Gjergjovë, Koprënckë, Gërmenj, Visockë, Qafë, Helmës, Backë, Melskë, Nikollarë, Dyrmish, Staraveckë"
Leshnje	"Fshatrat: Turbohovë, Kapinovë, Krastë, Krushovë, Faqekuq, Gostënckë, Leshnje, Vlushë, Bërsakë"
Gjerbës	"Fshatrat: Mëlovë, Zaloshtnjë, Gjerbës, Ujanik, Gradec, Strafcikë, Vishanj, Barçi 1, Barçi 2,

Bashkia Skrapar

Njësitë Administrative

Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre

Kuç, Rehovë, Grëmsh, Gjogovicë, Floq"

Zhepë

"Fshatrat: Grevë, Posten, Kovaçanj, Gurazez, Çorrotat, Cericë, Zhepë, Leskovë, Trebël, Dunckë, Rromas, Tërrovë, Dobrenj, Buranj, Luadh, Shpatanj"

5.9.2 PROFILI I BASHKISË

Bashkia e re e Skraparit ka një relief të thyer malor, i cili ka një territor shumë të gjerë dhe popullsi të ulët. Popullsia e zonës është pakësuar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit nga largimet e banorëve drejt qyteteve të mëdha të Shqipërisë apo në emigrim. Vetë qyteti i Çorovodës humbi mbi 40 për qind të popullsisë mes viteve 2001 dhe 2011, ndërsa shumë nga komunat përbërëse kanë humbur mbi gjysmën e popullsisë.

Mungesa e perspektivës, kryesisht ajo e vendeve të punës, ka bërë që banorët e qytetit të vendosen për një të ardhme më të mirë për fëmijët e tyre drejt qyteteve të mëdha, ndërsa banorët e zonave të thella janë larguar drejt qytetit të Çorovodës, si rezultat i mungesës së rrugëve dhe mjekëve në fshatrat e tyre. Problematika kryesore e banorëve të Çorovodës ka qenë gjendja e vështirë e rrugës kombëtare Skrapar-Berat.

Skrapari si burim kryesor ka të ardhurat që vijnë nga blegtoria dhe bujqësia, prodhime mjaft të vlerësuara këto në tregjet e vendit, ndër më të njohurat djathi dhe rakia e Skraparit. Vitet e fundit Skraparit i është shtuar shpresa për zhvillimin nëpërmjet turizmit. Kanionet e Skraparit, po tërheqin çdo ditë e më shumë vëmendjen e vizitorëve të huaj dhe vendas.

Mbi 20 mijë vizitorë mendohet se kanë prekur këtë bukuri të natyrës katër vitet e fundit. Turizmi fetar është një tjetër resurs i kësaj zone. Mijëra vizitorë shkelin në Skrapar çdo vit gjatë festës së Bektashinjve, gjatë ditëve të pelegrinazhit të muajit gusht. Por dhe këtë resurs të turizmit e pengon gjendja e vështirë e rrugës në fshatin Gjerbës, nga ku vizitorët duhet të udhëtojnë drejt malit të shenjtë Tomor.

Parku Kombëtar i Tomorit, është një tjetër resurs mjaft i rëndësishëm i kësaj zone, ende i pa vënë në shërbim të turizmit malor, si rezultat i mungesës së infrastrukturës dhe shërbimeve. Bashkimi i komunës Bogovë me Skraparin, i jep kësaj bashkie të re një tjetër mundësi për zhvillimin e turizmit. Uji që rrjedh nga zemra e malit, kodrat e hijshme, klima mjaft favorizuese dhe ushqimet e shijshme, i japin zonës elemente mjaft pozitive për zhvillimin e turizmit natyror. Ndryshe me pjesën tjetër të rrethit, nga Bogova nuk ka pasur lëvizje të mëdha të popullsisë. I gjithë fshati jeton me të ardhurat nga turizmi familjar. Pjesë e kësaj komune është fshati Novaj i njohur për gurin dekorativ.

Aktiviteti mineral privat, në rrethin e Skraparit, ka filluar në vitin 2001 dhe deri në Dhjetor të vitit 2014 janë aktive 25 leje minerare shfrytëzimi.

Në rrethin e Skraparit aktiviteti mineral është i zhvilluar në dy zona dhe konkretisht; në Novaj ku punohet për nxjerrjen e pllakave të gurit gëlqeror dhe në zonën e Milovës në nxjerrjen e gëlqerorit masiv.

5.9.3 LEJET MINERARE TË SHFRYTËZIMIT RRETHI I SKRAPARIT

Lloji i mineralit	Nr. i Lejeve
Gëlqeror i Mermerizuar	7
Gëlqeror Masiv	2
Gëlqeror Pllakor	9
Gur Gëlqeror	6
Ranor Pllakor	1
Shuma	25

5.9.4LISTA E KOMPANIVE QË VEPROJNË NË RAJONIN E SKRAPARIT

Nr.	Nr i lejes	Data e marrjes së lejes	Emri i subjektit	Rrethi	Emertimi i vendburimit	Lloji i Mineralit
1	656/1	19.06.2014	GOREZI, shpk,	Skrapar	Novaj	Gelqeror Pllakor
2	705/1	03.04.2013	KLERAJDI, shpk	Skrapar	Mali I Tomorrit, Rrasa e Novajt	Gelqeror Pllakor
3	766/1	29.10.2014	ALION, shpk	Skrapar	Novaj, Mali I Tomorrit	Gelqeror Pllakor
4	801	22.09.2004	GERI - 01, shpk	Skrapar	Novaj	Gelqeror Pllakor
5	862/1	26.05.2005	STONE PRODUCTION, shpk	Skrapar	Melove,	Gelq_Mermer
6	938	18.04.2006	GURI I BARDHE, shpk	Skrapar	Novaj	Gelqeror Pllakor
7	970	06.09.2006	FLORI, shpk	Skrapar	Milove	Gelqeror Pllakor
8	1017	11.05.2007	Qato-01, shpk	Skrapar	Novaj	Gelqeror Pllakor
9	1035	04.07.2007	Zotaj - Z, shpk	Skrapar	Novaj (gelqeror pllakor)	Gelqeror Pllakor
10	1052	03.08.2007	Pietra, shpk	Skrapar	Novaj (gelqeror Pllakor)	Gelqeror Pllakor
11	1059	03.08.2007	Malendi, shpk	Skrapar	Novaj (gelqeror pllakor)	Gelqeror Pllakor
12	1062	03.08.2007	Fraili, shpk	Skrapar	Novaj (Gelqeror Pllakor)	Gelqeror Pllakor
13	1233/1	16.09.2008	Asmida,	Skrapar	Kapinovë	Gëlqeror Pllakor

			shpk			
14	1293	19.12.2008	Emiliano, shpk	Skrapar	Pylli i Races- Novaj	Gelqeror Pllakor
15	1367	18.06.2009	Xhuljano 08, shpk	Skrapar	Novaj	Gelqeror Pllakor
16	1428	11.09.2009	Igli 07, shpk	Skrapar	Novaj, Skrapar	Gelqeror Pllakor
17	1437	16.09.2009	D.K.S Group, shpk	Skrapar	Vala (Ustia), Polican	Ranor Pllakor
18	1449	25.01.2010	Melove, shpk	Skrapar	Melova	Gelq_ Mermer
19	1548	27.06.2011	TOPI EKI, shpk	Skrapar	Afer fshatit milove dhe Zaloshnje	Gelqerori mermerizuar
20	1573	25.07.2013	LED- BJON, Sh.p.k	Skrapar	Novaj	Gelq. Pllakor
21	1617	19.03.2013	Zaloshnja Fiorentino, shpk	Skrapar	Fshati Zaloshnje, komuna Gjërbes,	Gelq i Mermerizuar
22	1652	07.08.2013	ËHITE STONE, Sh.p.k	Skrapar	Milove, Rrethi Skrapar	Gelqeror i mermerizuar
23	1656	16.08.2013	Vellezerit Hazisllari, Sh.p.k	Skrapar	Melove	Gelqeror i mermerizuar
24	1661/1	06.11.2014	Topi- Eki Shpk	Skrapar	Objekti Mëlovë	Gëlqeror Masiv
25	1719	12.06.2014	Dobrusha 2010, Sh.p.k	Skrapar	Dorez, Skrapar	Ranor Silicor

Tabela 44 – Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Skraparit

Burimi: AKBN 2014, Volumi III

5.10.1 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM



Zona Gjeografike: Bashkia Vau i Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Pukë dhe Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Vaut të Dejës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 30.438 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrir Civil, kjo bashki numëron 48.966 banorë. Bashkia e re ka në një sipërfaqe prej 499, 09 km² me një densitet

prej 98, 11 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Vau Dejës, Bushat, Vig-Mnele, Hajmel, Temal, Shllak. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Shkodrës dhe pjesë e po këtij qarku. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra.

Bashkia Vau - Dejës

Njësitë Administrative	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Vau-Dejës	"Qytetet Vau Dejes, Fshatrat: Mjede, Spathare, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë, Gomsiqe"
Bushat	"Fshatrat: Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hoten"
Vig-Mnele	"Fshatrat: Mnelë e Madhe, Mnelë e Vogël, Vig"
Hajmel	"Fshatrat: Hajmel, Dheu i Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë"
Temal	"Fshatrat: Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Kllogjen, Malagji-Kajvall, Toplanë, Sermë, Gushtë"
Shllak	"Fshatrat: Vukjakaj-Gegaj, Palaj-Gushaj, Benë, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj"

5.10.2 PROFILI I BASHKISË

Bashkia e Vaut të Dejës zgjerohet me 5 komuna, të cilat merren kryesisht me bujqësi, ndërsa zona ka resurse të konsiderueshme ujore. Në të ndodhet hidrocentrali i Vaut të Dejës si dhe HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2, të ndërtuara me koncesion privat gjatë viteve të fundit.

Komuna e Bushatit, e cila i shtohet Bashkisë së re është një zonë e njohur për prodhimet bujqësore dhe ka një aktivitet jo të vogël në eksportin e zarzavateve. Nga ana tjetër, Komunit Shllak dhe Temal gjenden në anën tjetër të liqenit të Vaut të Dejës dhe pa lidhje historike me bashkinë e re. Këto dy komuna janë veçanërisht të varfra me tokë për shkak se një pjesë e konsiderueshme e tyre është përmbytur nga liqeni i Vaut të Dejës.

Para viteve 90, shumica e banorëve në Vau të Dejës punonin në hidrocentral, në fabrikën e bakrit si dhe në kooperativa bujqësore. Ndërkohë që zhvillimi ekonomik aktual mbështetet kryesisht në bizneset e vogla të shërbimit, të cilat janë të pozicionuara kryesisht në qytetin Vau të Dejës.

Niveli i papunësisë është i lartë, ndaj edhe një pjesë e madhe e popullsisë gjendet në emigrim, kryesisht në shtetet e Italisë dhe Greqisë. E veçantë për këtë bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së Hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shkëputet nga lumi i parë, rreth 1 km në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës. Pasuria e madhe ujore e bën gjithashtu zonën të prekur nga përmbytjet.

Zhvillimi i turizmit natyror është një mundësi e rritjes ekonomike të kësaj zone, pasi në liqenin e Vaut të Dejës gjenden kështjella dhe kisha ndër më të vjetrat në Ballkan, të cilat ende sot mbartin vlera historike dhe arkeologjike.

Liqeni i Vaut të Dejës mund të kthehet gjithashtu në një burim të rëndësishëm turistik, në rast se rikthehet transporti për qëllime turistike nga Vau i Dejës deri në Koman.

5.10.3 HIDROCENTRALI I VAUT TË DEJËS

Vau i Dejës është hidrocentrali i parë që u ndërtua mbi lumin Drin dhe ndodhet në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë, në rrjedhën e poshtme të lumit Drin, në Grykën e Vaut të Dejës, rreth 18 km nga qyteti i Shkodrës. Duke qënë se Vau i Dejës është hidrocentrali më i poshtëm me digë dhe liqen në kaskadën e Drinit, rëndësia e tij përveç prodhimit të energjisë elektrike, lidhet edhe me ndikimin që ka liqeni i Vaut të Dejës në ultësirën e nën Shkodrës. Shkarkimet e ujit nga ky liqen kanë ndikim kryesor në përmbytjet që ndodhin në ultësirat e Lezhës dhe Shkodrës. Punimet për ndërtimin e tij nisën në vitin 1967. Ky impiant është vënë në punë në dy faza: Ag. 1, 2 dhe 3 në vitin 1970, ndërsa Ag. 4 & 5 në vitin 1975.



5.10.3.1 TREGUESIT TEKNIKË

Punimet për ndërtimin e tij nisën në vitin 1967. Ky impiant është vënë në punë në dy faza: Ag. 1, 2 dhe 3 në vitin 1970, ndërsa Ag.4 & 5 në vitin 1975. HEC Vau i Dejës është i tipit me digë dhe liqen. Për krijimin e liqenit të Vaut të Dejës janë ndërtuar 3 diga të veçanta:

Diga e Qyrsaqit, me lartësi 46.4m dhe gjatësi 440m, është e tipit; pjesërisht gravitacionale prej betoni dhe pjesërisht me mbushje me material vendi të formacionit gëlqeror. Në pjesën prej betoni të Digës janë vendosur 4 shkarkuesit sipërfaqësorë me portat radiale, si dhe Vepra e Marrjes me dy porta me segmente nga të cilat dalin 5 tubacionet e prurjes së ujit në agregatet e centralit. Kapaciteti maksimal i shkarkuesve është 3500 m³/s ndërsa kapaciteti i përpunimit të ujit në agregatë është 4 X 113 m³/s.

Diga e Zadejës, me lartësi 60m dhe gjatësi 390m, është e tipit me mbushje me material vendi të formacionit gëlqeror. Në këtë digë ndodhet edhe një shkarkues me tunel dhe portë me segmente që ka një kapacitet prej 3200 m³/s.

Diga e Rragamit ka një lartësi 34m dhe gjatësi 320 m. Kjo digë është e tipit me mbushje me material vendi të formacionit gëlqeror dhe flish. Në këtë digë nuk ndodhen vepra hidrike, ajo shërben vetëm si barrierë për mbajtjen e ujit.

Vëllimi maksimal i liqenit të Vaut të Dejës është 580 milion m³, sipërfaqja e tij është 25 km² dhe ai ngjitet nga gryka e Vaut të Dejës për rreth 27km në luginën e Lumit Drin, deri në afërsi të hidrocentralit të Komanit. Niveli maksimal i lejuar i ujit në liqen është 76m nnd ndërsa niveli minimal i operimit është 61m nnd. Vëllimi aktiv i liqenit është 263 milionë m³ ujë. HEC-Vau i Dejës si pjesë e kaskadës së Drinit është parashikuar si vepër e klasit të parë përse i përket nivelit të rrezikut. Prurja maksimale, me siguri, 1 herë në 10000 vjet është llogaritur 10000 m³/sek. Aftësia shkarkuese e përgjithshme e Hec Vau Dejës në kuotën 76 m është rreth 7500 m³/sek.

5.10.3.2 TREGUESIT E SHFRYTËZIMIT

Agregatët e centralit kanë turbina “Francis” vertikale me fuqi 50 MW secila, gjeneratorë sinkron 3- fazorë dhe transformatorë ngritës për lidhjen me nënstacionin. Fuqia totale e HEC-it është 250 MW. Në ndërtesën e Centralit janë montuar gjithashtu pajisjet ndihmëse, dhe të kontrollit e monitorimit. Hidrocentrali ka një rënie prej 54m dhe prurje mesatare prej 113 m³/sek për çdo agregat. Prodhimi mesatar vjetor është rreth 1000 GWh. Hidrocentrali u ndërtua me paisje dhe materiale teknologjike kineze, por gjatë viteve 2003-2007 është kryer rehabilitimi i plotë i hidrocentralit nga Andritz për pajisjet mekanike dhe Alstom për impiantet elektrike dhe kontrollin Nënstacioni me pajisjet e transmetimit, komandimit dhe mbrojtjes, mundëson lidhjen me Sistemin Energjetik nëpërmjet linjave 220Kv (Vau i Dejës-Tiranë, Vau i Dejës-Koman, Vau i Dejës-Elbasan,).

Parametrat teknike të shfrytëzimit HEC Vau i Dejës

Kapaciteti i instaluar (4 Ag.)	250 MW
Fuqia nom. e Gjeneratorëve	50 MW
Renia nominale	52 m
Konsumi nominal i ujit	113 m ³ /s

Prurja mesatare vjetore

Që nga vënia në punë	257 m ³ /s
Mesatarja (1994-2014)	276 m ³ /s
Mesatarja (2004-2014)	294 m ³ /s

Prodhimi mesatar vjetor

Që nga vënia në punë	901.180 MWh
Mesatarja (1994-2014)	973.300 MWh
Mesatarja (2004-2014)	982.970 MWh
Minimali (1990)	610.540 MWh
Maksimali (2010)	1.511.200 MWh

Niveli mesatar vjetor

Niveli minimal (Shkurt 1999)	67,91 m
Niveli maksimal (Shtator 2005)	75,33 m

Të dhëna teknike për hidrocentralin e Vaut të Dejës, të paraqitur në raportin EITI 2013-2014, janë si më poshtë:

Viti i fillimit të përdorimit	1971
Numri i agregatëve	5
Fuqia e instaluar për agregat	50MW
Fuqia e instaluar	250MW
Tipi i turbinave	Francis
Kapaciteti total i volumit në liqen	560 million m3
Lartësia maksimale e liqenit	76 m
Rënia nominale	52 m
Prodhimi mesatar vjetor	1,000 GWh

5.11 PASQYRIM I KUADRIT LIGJOR

Në tabelë në vijim jepet një pasqyrim i legjislacionit minerar të miratuar në Republikën e Shqipërisë.

Llojit i aktit ligjor	Nr dhe data e aktit ligjor	Objekti e aktit ligjor
Ligj	Ligji Nr. 10 304, datë 15.7.2010	<i>“Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet e Ligjit Nr. 9/2013 dhe Ligjit Nr. 134/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</i>
	Ligji Nr. 10 304, datë 15.7.2010	<i>“Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”</i>
	Ligjin 9975, datë 28.07.2008	<i>“Për Taksat Kombëtare, i ndryshuar”</i>
	Shtojca nr. 2 të ligjit 9975, date 28.07.2008.	<i>“Për Taksat Kombëtare, i ndryshuar”</i>
VKM	V.K.M. nr.7 datë 04.01.2012	<i>“Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”</i>
	V.K.M. nr. 201 datë 21.03.2012	<i>“Për disa ndryshim në V.K.M. nr.7 datë 04.01.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare””</i>
	VKM Nr. 218, datë 11.03.2015	<i>“Për përcaktimin e kriterëve,procedurave dhe rregullavepër shfrytëzimin, në sipërfaqedhe nëntokë, të zonave që janëngjitur me lejet ekzistuese dhendryshimin e koordinatave përlejet minerare të përcaktuaranë hapësirë me tri koordinata”.</i>

	VKM Nr. 248, datë 2.05.2012	<i>“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 347, datë 29.04.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të veprimit 3 vjeçar për miratimin e strategjisë minerare”.</i>
	VKM Nr. 479, datë 29.06.2011	<i>“Për miratimin e Strategjisë Minerare të Republikës së Shqipërisë”.</i>
	VKM Nr. 436, datë 16.06.2011	<i>“Për disa ndryshime në vendimin Nr. 538, datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta të ndryshuar”.</i>
	VKM Nr. 440, datë 16.06.2011	<i>“Për miratimin e formës, të kushteve të rikthimit dhe të mënyrës së llogaritjes së garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe për realizimin investimit”.</i>
	VKM Nr. 441, datë 16.06.2011	<i>“Për përcaktimin e kushteve të certifikimit e të licencimit, të dokumenteve shoqëruese, të afateve të vlefshmërisë dhe të procedurave të shqyrtimit të kërkesave, për licencimin e veprimtarisë studimore-projektuese në veprimtaritë minerare”.</i>
	VKM Nr. 442, datë 16.06.2011	<i>“Për miratimin e kushteve, të dokumenteve shoqëruese, të afateve të vlefshmërisë dhe të procedurave të shqyrtimit të kërkesave, për autorizimin e tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara”.</i>
	VKM Nr. 364, datë 04.05.2011	<i>“Për përcaktimin e kriterëve, të vlerës së sipërfaqes së zonës minimale të lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare”.</i>
	VKM Nr. 347, datë 29.04.2011	<i>“Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”.</i>
	VKM Nr. 362, datë 29.04.2011	<i>“Për miratimin e kriterëve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare”.</i>
	VKM Nr. 320, datë 21.4.2011	<i>“Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”.</i>

	VKM Nr. 232, datë 23.03.2011	<i>"Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin mineral të Republikës së Shqipërisë".</i>
	VKM Nr. 233, datë 23.03.2011	<i>"Për miratimin e formës së raporteve, të mënyrës së botimit të të dhënave për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare në sektorin mineral të Republikës së Shqipërisë, si dhe të nivelit të konfidencialitetit në kuadër të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse".</i>
	VKM Nr. 942, datë 17.11.2010	<i>"Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura".</i>
Urdhër Ministri	Urdhër Nr. 302, datë 12.04.2011	<i>"Për miratimin e parimeve baze për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, të planit të veprimtarive të mbylljes së veprimtarisë minerare, të mënyrës së përcaktimit të zonës së rrezikshme të një të drejte minerare dhe të planit të menaxhimit të mbetjeve minerare".</i>
	Urdhër Nr. 304, datë 13.04.2011	<i>"Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare".</i>
	Urdhër Nr. 305, datë 13.04.2011	<i>"Për procedurat dhe formën e hartimit të programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare".</i>
	Urdhër Nr. 306, datë 13.04.2011	<i>"Për procedurat dhe formën e hartimit të planit vjetor mineral".</i>
	Urdhër Nr. 307, datë 13.04.2011	<i>"Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet".</i>
	Urdhër Nr. 308, datë 13.04.2011	<i>"Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet".</i>
	Urdhër Nr. 309, datë 13.04.2011	<i>"Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore".</i>
	Urdhër Nr. 310, datë 13.04.2011	<i>"Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karriere për grupin e mineraleve ndërtimore".</i>

	Urdhër Nr. 311, datë 13.04.2011	<i>“Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga zotëruesit e lejeve minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara”.</i>
	Urdhër Nr. 312, datë 13.04.2011	<i>“Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së informacioneve të detyrueshme që përgatiten nga zotëruesit e lejeve”.</i>
	Urdhër Nr. 382, datë 20.05.2011	<i>“Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundravajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare”.</i>
	Urdhër Nr. 383, datë 20.05.2011	<i>“Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planit të veprimtarive për mbylljen e një veprimtarie minerare”.</i>
	Urdhër Nr. 384, datë 20.05.2011	<i>“Për miratimin e procedurave të regjistrimit dhe dokumentacionit që regjistrohet në kadastrën minerare dhe në regjistrin minerar, si dhe forma dhe procedura e raportimit të këtij dokumentacioni nga ana e zotëruesve të lejeve minerare”.</i>
	Urdhër Nr. 386, datë 20.05.2011	<i>“Për miratimin e rregullave për përdorimin e të dhënave minerare të një leje minerare”.</i>
	Urdhër Nr. 387, datë 20.05.2011	<i>“Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së projektit të konservimit të minierës”.</i>
	Urdhër Nr. 388, datë 20.05.2011	<i>“Për miratimin e formës dhe përmbajtjes të planit të monitorimit post-minerar”.</i>
	Urdhër Nr. 414, datë 03.06.2011	<i>“Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planit të menaxhimit dhe informacioneve që mbahen nga zotëruesi i lejes minerare për punimet e kryera, depozitimin, trajtimin e mbetjeve minerare dhe analizimin e tyre”.</i>
	Urdhër Nr. 477, datë 27.06.2011	<i>“Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurës së hartimit të aktit të miratimit dhe aktit të refuzimit për aplikimet e lejeve minerare”.</i>
	Urdhër Nr. 478, datë 27.06.2011	<i>“Për miratimin e formës, përmbajtjes së vendimeve të këshillave teknike të institucioneve të Sh.Gj.Sh dhe A.K.B.N për aplikimet e lejeve minerare, për shtyrjen e afatit të lejeve minerare dhe për shndërrimin e lejeve minerare të kërkim-zbulimit në leje minerare shfrytëzimi”</i>

	Urdhër Nr. 615, datë 02.09.2011	<i>"Për përcaktimin e njësisë së hartimit të dokumentacionit për përcaktimin e procedurave konkurruese, të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe kriterëve të kualifikimit dhe vlerësimit të ofertave për të drejtën e aplikimit për një leje minerare në zonat konkurruese".</i>
Udhëzime	Udhëzim i ministrit të Energjisë dhe Industrisë Nr. 718, datë 03.10.2011	<i>"Për mënyrën e vlerësimit të garancive financiare të lejeve minerare".</i>
	Udhëzimi ministrit të Energjisë dhe Industrisë Nr. 10, datë 26.01.2015	<i>"Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licensuara".</i>
	Udhëzim i ministrit të Energjisë dhe Industrisë Nr. 17, datë 28.01.2015	<i>"Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e nënkontraktimit të së drejtës së lejes minerare për kërkim-zbulim, për shfrytëzim apo për kërkim-zbulim-shfrytëzim".</i>
	Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 26 datë 04.09.2008	<i>"Për Taksat Kombëtare, i ndryshuar"</i>
	Raporti i normativave për minerale të ndryshme	<i>Normativat për minerale të ndryshme</i>
	Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 2, datë 17.1.2014	<i>Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 26, datë 4.9.2008 "për taksat kombëtare" të ndryshuar</i>
	Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr 2 /1, datë	<i>Në lidhje me rentën minerare</i>

	12.03.2014	
	Udhëzimi Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave Nr 2, datë 18.02.2014	<i>Mbi zbatimin praktik të Udhëzimit Nr 2/1</i>
	Vendimi i Komisionit Ad- Hoc nr. 10469 date 25.04.2014	<i>Per renten minerare</i>
	Vendimi nr.123, datë 11.2.2015	<i>“Për një shtesë në vendimin nr.7, datë 4.1.2012, të këshillit të ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”, të ndryshuar”</i>

Tabela 45- Kuadri ligjor i industrisë nxjerrëse

Burimi: <http://www.gsa.gov.al/alb/services/Mineralet/Legjislacioni.html>- www.dogana.gov.al

6. INDIKATORËT SPECIFIK TË IMPAKTIT SOCIAL-EKONOMIK NË NJË RAJON TË CAKTUAR.

Indikatorët specifikë janë bazuar në praktikat më të mira në botë ku kompanitë që veprojnë në industritë e naftës, gazit dhe minerale, dhe hidroenergjitike kanë dhënë një kontribut ekonomik social dhe në infrastrukturë për rajonin dhe komunitetin. Për të vënë në zbatim disa nga këto indikatorë, është ndërtuar një pyetësor që duhet të plotësohet nga bashkitë që administrojnë rajonet e industrisë nxjerrëse. Pyetësi që gjendet në Shtojcën 2 të dokumentit përmban një model të pyetësit dhe shpjegime të indikatorëve me impact, të cilat janë si më poshtë:

- Vlera direkte e realizuar dhe e shpërndarë.
- Implikimet financiare, risqet dhe mundësitë e rrjedhura nga ndryshimet klimaterike.
- Asistencë financiare e marrë nga qeveria.
- Zhvillimi dhe impakti i investimeve në infrastrukturë.
- Impakti indirekt dhe shkalla e këtij impakti.
- Përqindja e shpenzimeve të prokurimit të kryera nëpërmjet kompanive lokale.
- Investimi total në utilitete për të mbrojtur ambientin.

Ky pyetësor ju dërgua bashkive të zonave të industrisë nxjerrëse. Pyetësi rezultoi i vlefshëm, por i vështirë për tu plotësuar, për shkak të mungesës së marrjes sistematike dhe të kontrolluar të informacionit nga subjektet publike dhe private që veprojnë në atë zone ose dhe në nivel kombëtar.

Pyetësori u dërgua me postë elektronike tek të gjitha bashkitë, dhe u mundësua një takim tek një nga Bashkitë kryesore, siç është Bashkia Patos. Ky takim rezultoi me informacion të pjesshëm dhe jo të plotë.

7. VIZUALIZIMI DHE FUNKSIONALITETI I FAQES WEB

Si pjesë e metodologjisë së ndjekur për mënyrën e paraqitjes dhe publikimit të të dhënave në web, është menduar paraqitja e të dhënave në një hartë, me një ndërfaqe grafike dinamike. Për të ilustruar modelin e paraqitjes grafike të informacionit të grumbulluar, është përdorur Google Maps. Rekomandohet të përgatiten termat e referencës për ndërtimin e një aplikimi më të avancuar, i cili do të mundësojë paraqitjen më të plotë të të gjitha zonave të industrisë nxjerrëse në Shqipëri, integruar me Google Maps. Demonstrimi modest i idesë së vizualizimit paraqitet tek <http://ilab.dmcs-online.com/maps/>

Në faqen web do të jetë paraqitur grafikisht harta e Shqipërisë në të cilën do të theksohen me anë të shenjuesve zonat/bashkitë e interesit, në të cilat janë bërë studimet dhe matjet e treguesëve kryesore.




Figura 11. Harta e Shqipërisë dhe zonat e industrisë nxjerrëse

Secila prej zonave të industrisë nxjerrëse, të theksuara në hartë, do të jetë e klikueshme. Pasi një përdorues do të klikojë në njërin nga zonat që kërkon informacion, do të shfaqet një faqe-model, e cila pasqyron në mënyrë të përmbledhur dhe të përpunuar të dhënat e treguesve ekonomiko – socialë dhe ligjorë për zonën/bashkinë e klikuar.

Harta dhe aplikimi do të shfaqin një legjendë dinamike. Në legjendë, do të shfaqen disa kategori kryesore të industrive nxjerrëse (minerale, hidrokarbure, etj.) të cilat mund të përzgjidhen nga përdoruesit. Përdoruesi do të ketë mundësi të përzgjedhë një nga kategoritë për të cilat është i

interesuar të marrë informacion dhe pas zgjedhjes së një kategorie, në hartë do të paraqiten të dhënat kryesore të analizuara për kategorinë e përzgjedhur në atë zonë.

Në varësi të të ardhurave ekonomike dhe të investimit ekonomik, do të ndërtohet një hartë dinamike që do të marrë të dhënat nga baza e të dhënave, e cila do përditësohet në kohë reale.




Figura 12. Përzgjedhja e rajoneve nga harta

Nga ana e infrastrukturës teknike, sistemi do të përdorë një API (Application Programming Interface) të quajtur AM Map, i cili mundëson shfaqjen grafike të të dhënave, në varësi të investimit në komunitet.

Për çdo bashki do të jepen të dhënat mbi investimet e realizuara nga kompanitë e industrisë nxjerrëse dhe në varësi të shumave të investuara në komunitet, harta do pasqyrojë këto të dhëna duke lejuar që të bëhen krahasime midis investimeve në zona të ndryshme.

Do të ndërtohet një bazë të dhënash e cila do grumbullojë informacionin në vite dhe më pas ky informacion do shërbejë për të populluar hartën me të dhëna krahasuese ndërmjet bashkive. Për të ilustruar ndryshimet midis vlerave të investuara në komunitet do përdoren ngjyrat me kontrast të ndryshëm, të cilat variojnë në funksion të investimit. Nëpërmjet kësaj mënyre paraqitjeje, në hartë do të jenë lehtësisht të dallueshme bashkitë me investimin më të madh në komunitet dhe ato me më pak investim.

Saktësia e shfaqjes varet nga informacioni që bashkitë do të vënë në dispozicion.

Aplikimi do të mundësojë futjen e të dhënave direkt nga bashkitë dhe aprovimin e shfaqjes për publikun nga AlbEITI.

7.1 PROTOTIPI (WEB-MODEL)

Sistemi do të mundësojë paraqitjen e të dhënave në formë të grupuar, në mënyrë që identifikimi i tyre të jetë më i lehtë dhe më i shpejtë.

Grupimi do të realizohet në bazë të kategorive kryesore të indikatorëve, të cilat janë: Socio-Ekonomik, Juridik, Teknik dhe Social. Në pamjen e parë vizuale që do t'i shfaqet përdoruesit, do të jenë të dukshëm vetëm këto grupe kryesore të indikatorëve.

Secili prej grupimeve do të jetë i klikueshëm dhe nëse përdoruesi do të klikojë njërin prej tyre, do të shfaqen indikatorët e tjerë të cilët përbëjnë indikatorin kryesor. Përdoruesi më pas do të ketë mundësinë të klikojë në indikatorin për të cilin ka interes të marrë informacione.

Prodhimi historik i mineralve sipas AKBN11

Minerali	Njësia	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Krom	në '000 ton	202	225	284	328	350	360	521
Bakër	në '000 ton	98	105	114	140	305	480	508
Hekur-nikeli dhe nikeli-silikat	në '000 ton	370	353	69	269	364	75	215
Qymyr	në '000 ton	4	2	2	-	1	1	-
Gur gëlqeror	në '000 m3	1,716	3,838	3,272	2,363	2,446	2,727	1,811
Gur gëlqeror	në '000 m3	1,716	3,838	3,272	2,363	2,446	2,727	1,811
Argjilë	në '000 ton	765	649	796	795	973	961	768
Gips	në '000 ton	54	87	71	77	93	91	112

Figura 13. Paraqitje e tabelave bazuar në indikatorë

Menjëherë pas kësaj, sistemi do të shfaqë një tabelë të organizuar në mënyrë të tillë ku për çdo bashki do të paraqiten vlerat e indikatorëve në vite të ndryshme të marrë në konsideratë. Përdoruesi do të ketë mundësinë të shohë të dhënat që dëshiron, për zonën e interesit dhe vitin për të cilin është i interesuar.

Sistemi do të jetë i lidhur më një bazë të dhënash, në të cilën, të dhënat do të përditësohen në mënyrë automatike. Baza e të dhënave do grumbullojë informacionin në vite dhe më pas ky informacion do shërbejë për të populluar tabelat e indikatorëve me të dhëna për bashkitë e ndryshme. Nëpërmjet kësaj mënyre paraqitjeje, ku informacioni do jetë i grupuar sipas zonave të industrive nxjerrëse dhe sipas

viteve, do të jetë shumë e lehtë që të realizohen krahasime të vlerave të indikatorëve gjatë viteve apo edhe ndërmjet zonave të ndryshme.

Detaje të metejshme të shfaqjes ofrohen tek Shtojca 3.

8. KONKLUZIONE

- Procesi i pasqyrimit dhe transparencës së informacionit në lidhje me industrinë e hidrokarbureve dhe atë minerare është një hap i rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve të komunitetit të biznesit, qeverisë qendrore dhe lokale si dhe komuniteteve lokale ku operojnë ndërmarjet që janë të lincensuara për shfrytëzimin dhe komercializimin e produkteve të kësaj industrie.
- Ky proces kërkon një ndjekje sistematike të detyrave operacionale dhe një strukturim të mirë organizuar të të gjithë institucioneve të përfshira në këtë proces.
- Institucionet mbikqyrëse duhet të krijojnë një marrëdhënie më ndërvepruese me kompaninë e lincensuar për të bërë të mundur raportimin në kohë dhe cilësi të informacionit sipas detyrimeve përkatëse.
- Është e nevojshme të shtohet kërkesa për llojin dhe strukturën e informacionit nga kompania me qëllim përshtatjen më të mirë të kërkesës së investitorëve potencialë dhe aktualë me nevojat e tregut të kësaj industrie. Në këtë raport, ne kemi demonstruar një profil të informacionit përdoret nga kompania e lincensuar si në Shtojca 4.
- Pushteti lokal është një aktor i rëndësishëm dhe kërkohet të jetë më i angazhuar si dhe të ngrejë kapacitetet statistikore dhe analitike të përpunimit të informacionit që ka lidhje me investimet dhe impaktin e këtyre investimeve në këtë industri.
- Për efekt të marrjes së të dhënave të sakta dhe për pasqyrim të tyre transparent dhe në faqen e internetit, kërkohet që të ndiqet metodologjia e grumbullimit të të dhënave bazuar në vite, dmth grumbullohen të dhënat sipas indikatorëve për një vit, dhe më pas kalohet tek viti pasardhës dhe kështu me rradhë. Kjo plotëson boshllëkun e informacionit sistematik.

SHTOJCA 1. REFERENCAT

1. Raporte dhe publikime. www.albeiti.org
2. Treguesit e sektorit të hidrokarbureve. www.instat.gov.al
3. Global reporting initiative, oil and gas. <https://www.globalreporting.org/resource/library/GRI-G4-Oil-and-Gas-Sector-Disclosures.pdf>
4. Extractive industries transparency initiatives. https://eiti.org/files/English_EITI_STANDARD.pdf
5. Mining in America. https://eiti.org/files/English_EITI_STANDARD.pdf
6. <http://www.instat.gov.al/al/themes/llogarit%C3%AB-kombetare/publications/books/2014/vlera-e-shtuar-bruto-tremujori-iii-2014.aspx>
7. http://www.instat.gov.al/media/280637/tbp_2009-2011.pdf
8. http://www.instat.gov.al/media/251599/manual_metodologjik.pdf
9. <http://www.instat.gov.al/al/themes/energjia.aspx>
10. <http://www.instat.gov.al/al/themes/llogarit%C3%AB-kombetare.aspx>
11. http://www.ere.gov.al/doc/Raporti_Vjetor_ERE_2014.pdf
12. http://www.gsa.gov.al/PDF/Legjislacioni%20Minerar%20i%20Miratuar/3%20VKM%20nr.233_date_23.3.2011_eiti.pdf
13. http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2015/01/EITI-Report-2012_Albanian_15_1_2015-1.pdf
14. http://www.gsa.gov.al/PDF/Legjislacioni%20Minerar%20i%20Miratuar/3%20VKM%20nr.233_date_23.3.2011_eiti.pdf
15. http://www.gsa.gov.al/PDF/Legjislacioni%20Minerar%20i%20Miratuar/3%20VKM%20nr.233_date_23.3.2011_eiti.pdf
16. http://www.gsa.gov.al/alb/services/Mineralet/Legjislacioni.html#pjesa_II
17. <http://www.instat.gov.al/al/themes/niveli-i-jetes%C3%ABs.aspx>

SHTOJCA 2 - PYETËSOR PËR BASHKITË

Qëllimi: Vlerësimi i impaktit social, ekonomik dhe ambiental të investimeve në sektorin minerar për rajone që administrohen nga bashkitë e vendit tonë.

A. Investimet komunitare nga kompanitë e lincensuara që nuk lidhen me operacionet e biznesit

Këtu përfshihen shpenzimet e kompanisë për infrastrukturë që nuk lidhen me operacionet e biznesit të kësaj kompanie, donacionet e dhëna për NGO (organizata jo qeveritare) dhe shoqata të ndryshme me motive etike, fonde, të dhëna për komunitetin në nevojë, për shëndetësinë, arsimin etj.

1. A keni informacion në lidhje me investimet e mësipërme nga kompanitë që veprojnë në sektorin e shfrytëzimit të minierave?

- ☐ Po
- ☐ Jo

2. Nëse keni informacion, cilat janë fushat e këtyre investimeve?

- ☐ Edukim
- ☐ Shëndetësi
- ☐ Infrastrukturë rrugore
- ☐ Zhvillim komuniteti
- ☐ Bujqësi/ Blegtori
- ☐ Të tjera

3. Sa është vlera e raportuar për këto investime, nga këto kompani?

- Edukim _____
- Shëndetësi _____
- Infrastrukturë rrugore _____
- Zhvillim komuniteti _____
- Të tjera _____

4. A keni informacion në lidhje me mbështetjen financiare e dhënë nga qeveria për këto kompani?

- ☐ Po
- ☐ Jo

5. Nëse keni informacion për këtë mbështetje financiare, në çfarë fushash është ajo dhe sa është vlera përkatëse?

- ☐ Lehtësira fiskale dhe tatimore _____
- ☐ Subvencione _____
- ☐ Grante investimesh, kërkim dhe zhvillim dhe lloje të tjera grantesh _____
- ☐ Çmime _____
- ☐ Lehtësira në detyrimet për përdorim prone _____
- ☐ Asistencë financiare nga agjensitë e eksportit _____
- ☐ Insentiva financiare _____
- ☐ Të tjera _____

6. A keni informacion për impaktin e investimeve në sektorin minerar në rajonin tuaj?

- ☐ Po
- ☐ Jo

7. Nëse keni informacion çfarë treguesish keni për sa më poshtë.

- Rritja e punësimit (%)
- Rritja e bizneseve start up (%)
- Rritja e numrit të shkollave (%)
- Rritja e numrit të qendrave shëndetësore (%)
- Rritja e qendrave të kualifikimit profesional (%)

8. A keni informacion për impaktin indirekt dhe shkallën e këtij impakti për investimet në sektorin minerar në rajonin tuaj?

- ☐ Po
- ☐ Jo

9. Nëse keni, sa është shkalla e këtij impakti në bazë të informacionit dhe studimeve që ju keni kryer?

- Ndryshimi i produktivitetit të kompanive që operojnë në rajonin tuaj (%) _____
- Zhvillimi ekonomik në zona me varfëri të lartë (%) _____
- Impakti ekonomik në përmirësimin apo përkeqësimin e kushteve sociale dhe ambientale (%) _____
- Dispoziteti i produkteve apo shërbimeve për njerëzit në nevojë (%) _____
- Rritja e aftësive dhe njohurive në komunitetet lokale (%) _____
- Punët e hapura që kanë lidhje me sektorin e hidrokarbureve (%) _____
- Stimulimi i investimeve të huaja (%) _____
- Impakti ekonomik i përdorimit të produkteve apo shërbimeve të kompanisë (%) _____
- Bashkëpunimi mes pushtetit vendor dhe kompanive private (%) _____

10. A keni informacion në lidhje me përqindjen shpenzimeve të prokurimit të kryera nëpërmjet kompanive lokale?

- ☐ Po
- ☐ Jo

11. Nëse keni, sa është kjo përqindje?

Përqindja e buxhetit të prokurimeve me kompani lokale përkundrejt totalit të buxhetit të prokurimeve (%) _____

12. A keni informacion në lidhje me investimin total në utilitete për të mbrojtur ambientin nga kompanitë që kanë investuar në sektorin minerar?

- ☐ Po
- ☐ Jo

13. Nëse po, cilat janë dhe sa janë këto investime?

- Materiale _____
- Energji _____
- Ujë _____
- Shërbime ekosistemi që përfshin dhe biodiversitetin _____
- Emisione _____
- Mbetje _____
- Produkte dhe shërbime _____
- Transport _____
- Vlerësimi i ofruesve të shërbimeve ambiente _____
- Çështje mosmarrëveshesh për ambientin _____

14. Të dhëna të tjera të përgjithshme që lidhen me komunën tuaj:

Popullsia, Nr. Burrave, Nr. Grave, % e papunësisë, Buxheti vjetor, Industria me kryesore, Shkollat kryesore (të mesme apo të larta), Sipërfaqja, Numri i shoqatave të shoqërisë civile në zone, Tjetër:

SH2.1 INDIKATORËT SPECIFIKË

Ky seksion mbart shpjegimin e indikatorëve të përdorur në pyetsor.

SH2.1.1 VLERA DIREKTE E REALIZUAR DHE E SHPËRNDARË

Vlera direkte e realizuar përfshin

- Shitjet neto
- Të ardhura nga investimet financiare
- Të ardhura nga shitja e aseteve fizike dhe pasuritë intelektuale.

Pagat e punonjëseve dhe përfitimet përfshin

- Listën e pagesave dhe përfitimet që lidhen me kontributet e rregullta si siguracionet, pensionet, shëndetin, etj. si dhe pagesa të tjera për strehimin, kredi të lira për punonjësit, asistencë, transport apo shërbime trajnimi.

Pagesa e dividendit dhe interesit përfshin

- Dividendi për aksioneret dhe interesat e paguara për huatë e marra

Pagesa për qeverinë përfshin

- Të gjitha llojet e taksave dhe detyrimeve të tjera përkatëse në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar

Investimet komunitare përfshijnë

shpenzimet e kompanisë për infrastrukturë që nuk lidhet me operacionet e biznesit të kësaj kompanie, donacionet e dhëna për NGO (organizatat jo-qeveritare) dhe shoqata të ndryshme me motive etike, fonde të dhëna për komunitetin në nevojë, për shëndetësinë, arsimin etj.

SH2.1.2 RREZIQET, MUNDËSITË DHE IMPLIKIMET FINANCIARE

Raporti i kompanisë duhet të përmbajë informacion në lidhje me rreziqet dhe mundësitë që shfaqen nga ndryshimet klimaterike dhe që mund të ndikojnë në operacionet e kompanisë, të ardhurat dhe shpenzimet.

- Një përshkrim të rreziqeve dhe mundësive dhe klasifikimit si fizike, rregullatore apo tjetër.
- Përshkrim i impaktit të këtyre rreziqeve dhe mundësive.
- Implikimi financiar i tyre përpara se veprimi të kryhet.
- Metoda e përdorur për vlerësimin e rreziqeve dhe mundësive.
- Kosto e veprimit për të manaxhuar.

SH2.1.3 MBËSHTETJA FINANCIARE E DHËNË NGA QEVERIA

Vlera e mbështetjes financiare pasqyron produktin, tipin e asistencës dhe vlerën e saj.

Shpjegime

- Lehtësira fiskale dhe tatimore
- Subvencione
- Grante investimesh, kërkim dhe zhvillim dhe lloje të tjera grantesh
- Çmime
- Lehtësira në detyrimet për përdorim prone
- Asistencë financiare nga agjensitë e eksportit
- Asistencë Financiare nga Export Credit Agencies (ECAs)
- Insentiva financiare
- Të tjera

SH2.1.4 ZHVILLIMI DHE IMPAKTI I INVESTIMEVE NË INFRASTRUKTURË

Raporti duhet të përmbajë investimet kryesore në infrastrukturë dhe shërbimet e mbuluara dhe duhet të paraqesë nëse këto investime janë me qëllim komercial apo angazhim etik. Disa nga

indikatorëtshfaqen si më poshtë: *Rritja e punësimit %; Rritja e bizneseve start up %; Rritja e numrit të shkollave %; Rritja e numrit të qendrave shëndetësore %*

SH2.1.5 IMPAKTI INDIREKT DHE SHKALLA E KËTIJ IMPAKTI:

- Ndryshimi i produktivitetit të kompanive të rajonit, sektorit apo ekonomisë.
- Zhvillimi ekonomik në zona me varfëri të lartë.
- Impakti ekonomik në përmirësimin apo përkeqësimin e kushteve sociale dhe ambientale.
- Dispoziteti i produkteve apo shërbimeve për njerëzit në nevojë.
- Rritja e aftësive dhe njohurive në komunitetet lokale.
- Punët e hapura në zinxhirin e vlerës.
- Stimulimi i investimeve të huaja .
- Impakti ekonomik i përdorimit të produkteve apo shërbimeve të kompanisë.

Tabela respektive që krijohet duhet të përmbaj fushat/indikatorët e mëposhtme:

(Produkti, produktiviteti i punës, vlera e akumuluar e investimeve të huaja, punësimi, startups, vlera e investimeve në edukim, e cila aplikohet sipas industrisëapo rajonit).

SH2.1.6 INVESTIMI TOTAL NË UTILITETE PËR TË MBROJTUR AMBIENTIN

Treguesi i investimeve për mbrojtjen sipas ambientit përmban tabelën me fusha/indikatorë produkti, masapër mbrojtjen e ambientit, apo dhe vlera të investimeve sipas produkteve apo rajonit.

Grumbullimi, analiza dhe komentet në këtë studim të të dhënave tekniko – ekonomike dhe social – juridike në zonat e industrisë nxjerrëse të vlerave aktuale dhe të perspektivës, do të bëhet:

- për zonat hidrokarbure (Bashkia Patos)
- për zonat minerare (Bashkia Bulqizë, Bashkia Fushë-Arrëz, Bashkia Pukë, Bashkia Has, Bashkia Skrapar, Bashkia Përrenjas dhe Bashkia Selenicë)
- për zonat hidroenergjetike Bashkia Vau Dejës

SHTOJCA 3 – FAQE MODEL

Vizualizimi ose mënyra e shfaqjes online do të bazohet në faqet model të krijuara për kategoritë dhe në hierarkinë e mëposhtme sipas niveleve: kombëtar; bashkie; kompanie

Kjo shërben si informacion orientues dhe demonstrative për ndërtimin e faqes për hartimin e hartës potenciale të industrisë nxjerrëse, trajta përfundimtare e së cilës do të jetë subjekt i një vlerësimi tjetër më të detajuar.

3.1 FAQJA-MODEL E BASHKISË

Disa nga të dhënat që do të shfaqen mund të jenë të organizuara sipas fushave të mëposhtme:

(Logo, Përshkrim, Popullsia, Njësi Administrative, Shoqëri civile, statistika, fotografi, aktivitete etj.)

Një faqe-model bashkie do jetë i organizuar në mënyrë të tillë që informacioni të mund të strukturohet në tre grupime kryesore:

1. **Të dhëna të përgjithshme**, duke përfshirë këtu aspekte gjeografike, popullsia, njësitë administrative, etj.
2. **Tregues**, do të jetë një tjetër strukturë e cila do të përmbajë informacion për tregues të fushave të ndryshme: ekonomikë, socialë, etj.
3. **Kompanitë** që operojnë në zonën e përzgjedhur. Në këtë grupim do të paraqitet informacioni (tregues, imazhe, etj) në lidhje me kompanitë e zonës për të cilën përdoruesi interesohet. Përdoruesi, duke klikuar emrin e kompanisë për të cilën dëshiron të marrë informacion do të drejtohet për tek profili i asaj kompanie

Mvarësisht organizimit dhe grupimit, sfida kryesore mbetet plotësimi me të dhëna dhe informacione nga bashkitë, të cilat në të shumtë e rasteve mungojnë të jenë të strukturuara, dhe lehtësisht të gjenerueshme.

Faqja-model tek Figura 14 është një variant shfaqjeje.




Figura 14. Faqe-model e Bashkisë Patos -Të dhëna të përgjithshme




Figura 15. Faqe-model e Bashkisë Patos– Tregues




Figura 16. Faqe-model e Bashkisë Patos – Kompanitë

3.2 FAQJA MODEL – KOMPANIA

Fushat e preferuara (Logo, emri i subjektit, NIPT, dhe të dhëna të tjera që mundësojnë përkrahimin më të plotë të subjektit të licensuar)

← → ↺ 🏠

http://ilab.dms-online.com/maps/

Kompanitë

+ Beralb sha

+ Okeola shpk

+ Graniti shpk

+ Donaj shpk

+ Koka shpk

+ Drini-1, shpk

Beralb Sha

Emri i subjektit:	"BERALB" sha
Nipt	K12107002A
Nr. lejës minerare:	Nr. 1555
Data e marrjes së lejës:	22.02.2012
Rrethi:	Pukë
Emërtimi i vendburimit:	Kama 2, Pukë
Vendndodhja e objektit:	Kama 2, Pukë
Lloji i mineralit:	Bakër
Sipërfaqja e objektit:	S = 0.68 km ²
Cilësia e mineralit:	Cu = (1.6 – 1.8) %
Lloji i lejes minerare:	Shfrytëzimi
Investimet gjatë vitit 2014:	ΣInv. ~ 18 148 621 lekë

Figura 17. Faqe-model i një subjekti të licensuar

Aneksi 1

Forma e Raportimit për NTIN (EITI)—Shqipëria			
A. Forma e Raportimit nga Kompanitë e Industrisë Minerare			
Vendi:	Kompania:		
NIPT:	Adresa:		
Kodi ekonomik i veprimtarisë:	Tel:		
	E-mail:		
Periudha e raportimit:	Viti:		
Informacione të detyrueshme	Referenca në bilancin e kompanisë	Volume	Vlera (në lek)
Të ardhurat për shtetin (Taksat) që paguhen nga kompanitë			
1a) Tatim Fitimi			
1b) Renta Minerare			
	- në lek		
	- në natyre		
1c) pagesa që lidhen me detyrimet e lejes minerare, pagesa të tjera të lidhura me procedurat e licencimit (specifikojë)			
1d) Bonuse të dhëna, bonuse për prodhimin			
1e) Sigurimi jetës,			
1f) Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore			
1g) Pagesa të tjera për autoritetet lokale të specifikuara			
a) Taksë gjelbërimi			
b) Taksë Tabele			
c) Taksë Pastrimi			
d) Tatim pasurie			
1 h) TAP (Tatim mbi të ardhurat Personale)			
a) Tatim i të ardhurave nga punësimi			
b) Tatime mbi të Ardhurat e mbajtur në Burim			
c) Tatimi mbi të Ardhurat nga Devidentet dhe Aksionet			
1 i) TVSH			
1 j) Taksa doganore			

Të ardhura të tjera (Informacion vullnetar)	Ref	Volume	Vlera (në lek)

Për nënshkrim nga nëpunësi përgjegjës i Kompanisë së Industrisë Minerare

Ne njohim përgjegjësinë tonë se të dhënat e prezantuara në raportin e mësipërm janë në përputhje me të dhënat e regjistrave tanë me përjashtim të:

Emri

Firma

Vula

Pozicioni

Date.../.../20.....

SHTOJCA 5 – PËRMBLEDHJE E BURIMEVE TË TABELAVE

Tabela	Burimi
Tabela 1 - Treguesit gjenerik të sektorit të mineraleve për vitin 2014 sipas llojit të produktit	<i>AKBN, 2014</i>
Tabela 2- Të ardhurat e qeverisë nga sektori i hidrokarbure dhe i mineraleve	<i>Raporti EITI 2013-2014</i>
Tabela 3- Prodhimi, punësimi dhe rendimenti i industrisë së naftës, gazit dhe mineraleve	<i>EITI – Raporti për vitin 2012, Raporti për vitin 2013-2014</i>
Tabela 4/Figura 4 - Treguesit e lejeve të shfrytëzimit të mineraleve për vitin 2014 sipas rajonit	<i>Raporti i AKBN, volumni i parë 2014, tabela 1</i>
Tabela 5- Treguesi dinamik i prodhimit të disa mineraleve në vite (Njësia 000 Ton/Nm3)	<i>EITI – Raporti për vitin 2012, Raporti për vitin 2013-2014</i>
Tabela 6 - Grumbullimi i Rentës minerare në vite (në Mil lekë)	<i>EITI – Raporti për vitin 2012, Raporti për vitin 2013-2014</i>
Tabela 7 - Eksporti i naftës dhe gazit, kromit dhe bakrit (2011-2014) në Mil. Lekë	<i>EITI – Raporti për vitin 2012, Raporti për vitin 2013-2014</i>
Tabela 8 - Treguesit teknik të naftës dhe gazit	<i>Raporti EITI 2012, tabela 5</i>

Tabelat 9-12	<i>“Zhvillimi i qendrueshëm i veprimtarive minerare në Shqipëri”- Sokol MATI</i>
Tabela 13- Kontributi industrisë nxjerrëse në ekonominë shqiptare (miliard lekë)	<i>EITI – Raporti për vitin 2012, Raporti për vitin 2013-2014</i>
Tabela 14- Prodhimi i Brendshëm Bruto ndër vite sipas aktivitetit	<i>Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Projekti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2015- 2017, http://www.financa.gov.al/</i>
Tabela 15- Rritja reale vjetore e Prodhimit të Brendshëm Bruto sipas aktivitetit ekonomik (në %)	<i>Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Projekti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2015- 2017, http://www.financa.gov.al/</i>
Tabela 16- Kontributi i Sektorëve të Industrisë në rritjen reale të PBB (në pikë %)	<i>Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Projekti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2015- 2017, http://www.financa.gov.al/</i>
Tabela 17 - Deklarimet vjetore kalendarike të subjekteve në Shqipëri për vitin 2014	<i>AKBN - Deklarimet e subjekteve për 2014</i>
Tabela 18 - Eksporti naftës bruto sipas destinacionit në vitin 2013	<i>http://open.data.al/</i>

Tabela 19 - Popullsia sipas rajoneve minerare dhe të hidrokarbureve	<i>http://zgjedhje2015.reporter.al</i>
Tabela 20 - Struktura e punësimit sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik	<i>Anketa e Forcave të Punës, 2013,2014 INSTAT</i>
Tabela 21 - Orët mesatare të punës në javë për të punësuarit me pagë sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik	<i>Anketa e Forcave të Punës, 2013,2014 INSTAT</i>
Tabela 22 - Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas aktiviteteve ekonomike dhe gjinisë, 2014	<i>Anketa e Forcave të Punës, 2013,2014 INSTAT</i>
Tabela 23 - Deklarimet vjetore kalendarike të subjekteve në Shqipëri për vitin 2014 për punësimin	<i>AKBN 2014</i>
Tabela 24 - Treguesit social ekonomik të rajoneve minerare për rajonet (Censusi 2011)	<i>INSTAT http://instatgis.gov.al</i>
Tabela 25 – Transferta e pakushtëzuar dhe specifike për bashkitë për vitin 2016 (në 000/lekë)	<i>Ministria e Financave, http://www.financa.gov.al/</i>
Tabela 26 - Statistika social - demografike të rajonit	<i>http://zgjedhje2015.reporter.al</i>
Tabela 27 - Treguesit gjenerik të sektorit të mineraleve në rajonin e Bulqizës për 2014	<i>Raporti AKBN 2014</i>

Tabela 28 - Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Bulqizës	<i>Raporti AKBN 2014</i>
Tabela 29 - Të dhëna ekonomike të kompanive që veprojnë në zonën e Bulqizës	<i>Raporti AKBN 2014</i>
Tabela 30- Rezervat e mineralit të Kromit të masivit Batër Bulqizë	<i>“Zhvillimi i qendrueshëm i veprimtarive minerare në Shqipëri”- Sokol MATI</i>
Tabela 31 - Statistika social - demografike të rajonit të Patosit dhe harta e Patosit	<i>http://zgjedhje2015.reporter.al</i>
Tabela 32 - Kompanitë që veprojnë në zonën e Patosit	<i>EITI – Raporti për vitin 2012, Raporti për vitin 2013-2014</i>
Tabela 33 - Projektet e Investimeve në komunitetin e Patosit dhe Fierit (në USD)	<i>AKBN 2014</i>
Tabela 34 – Mbështetje e komunitetit nga Bankers në Patos	<i>Kompania Bankers</i>
Tabela 35 - Buxheti i njësisë vendore qendrore	<i>Ministria e Financave, DPD</i>
Tabela 36 -Rezervat gjeologjike dhe të përdorura, bazuar në studimet 1985 - 1990 dhe prodhimi i akumuluar deri në 2014	<i>Raporti EITI 2013-2014, tabela 2</i>
Tabela 37 – Popullsia dhe densiteti i popullsisë për Fushë-Arrëz sipas Censusit 2011 dhe Regjistrit Civil	<i>http://zgjedhje2015.reporter.al</i>
Tabela 38 – Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Fushë- Arrës	<i>http://zgjedhje2015.reporter.al</i>
Tabela 39 – Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Hasit	<i>AKBN 2014</i>
Tabela 40- Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Prrenjasit	<i>AKBN 2014</i>

Tabela 41 – Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Pukës	<i>AKBN 2014</i>
Tabela 42 – Projektet e Investimeve në bashkinë e Pukës	<i>http://www.bashkiapuke.gov.al/projekte/investime-te-perfunduar-ne-qytetin-e-pukes/</i>
Tabela 43 – Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Selenicës	<i>AKBN 2014</i>
Tabela 44 – Lista e kompanive që veprojnë në rajonin e Skraparit	<i>AKBN 2014</i>
Tabela 45- Kuadri ligjor i industrisë nxjerrëse	<i>http://www.gsa.gov.al/alb/services/Mineralet/Legjislacioni.html www.dogana.gov.al</i>

Ky punim u mbështet nga Fondi Shumëdonator i Mbështetjes Programatike Globale për Industrinë Nxjerrëse (EGPS), i administruar nga Banka Botërore. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bankës Botërore, Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të saj apo qeverive që ata përfaqësojnë.